




» GRUPI F: KUALIFIKOHEN PARAGUAI DHE SLLOVAKIA

» GRUPI E: KUALIFIKOHEN HOLANDA DHE JAPONIA



PA DELL DHE GUXIM

Ambasadori Amerikan Christopher Dell ka kritikuar qasjen e institucioneve kosovare për zhvillimin ekonomik. Ai tha se në këtë vend është rrezik për të bërë biznes dhe Qeveria nuk mund të mburret me aftësinë e saj për t' i joshur investitorët e huaj. Dell kërkoi guxim nga Qeveria që t' i shtyjë reformat. ■ f10



Pavarësisht rritjes ekonomike, Kosova vjet është përballur me rënie të investimeve të huaja, tkurrje të kredidhënies, rritje të kredive të këqija, rënie të remitencave, si dhe rritje marramendëse të papunësisë. Express sjell raportin e Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2009, i cili flet për një situatë të rëndë ekonomike. ■ f11

VITI I MBRAPSHTË

Përplasen për pronë në Skënderaj

Tre persona janë plagosur brenda objektit të Komunës së Skenderajt, të enjten, pas një mosmarrëveshjeje rreth kontraktimit të shitblerjes së një prone. | FAQE 7

Telashe me deputetë

Zyrtarë të lartë kosovarë, duke mos respektuar procedurat e udhëtimeve zyrtare, po shkaktojnë probleme nëpër aeroportet ndërkombëtare. Ministri Hyseni ka kërkuar nga Kryeministri Thaçi që të vihen rregulla për disiplinimin e zyrtarëve që posedojnë pasaporta diplomatike. | FAQE 6

QKU'në e shkatërroi politika

Shumica e ish drejtorëve të QKU'së thonë se politika e ka shkatërruar atë. Ata japin sugjerimet se si do të mund të ndryshohet gjendja, veprime që vetë nuk kanë mundur t' i bëjnë kurrë. | FAQE 8-9

Express

E premte

25 qershor, 2010

www.gazetaexpress.com

N° 1909, Viti V, Çmimi: 0.10 € • E përditshme e pavarur kosovare



FOTO: ATDHE MULLA

Gjatë bisedimeve mes Prishtinës dhe Beogradit nuk do të hapet çështja e statusit dhe as ajo e ndarjes. Kjo është porosia që ka sjell në Prishtinë David Ledington, Ministër për Europë i Mbretërisë së Bashkuar. Ai tha se Londra dhe zyrtarët në Bruksel po angazhohen që BE të dalë me qëndrim të përbashkët për opinionin e GJND'së. ■ f4-5

PIKAT QE S'PREKEN

Informohu i pari!

Dërgo SMS në 2010 me fjalën "gol" dhe prano rezultatet e fundit nga Kampionati Botëror 2010.

Çmimi është 2 EUR për tërë kampionatin.



Pressing

Express

■ Kryeredaktor: Berat Buzhala berat.buzhala@gazetaexpress.com, Zv. Kryeredaktore: Arlinda Desku arlinda.desku@gazetaexpress.com,
 ■ Redaktor përgjegjës: Ilir Mirena ilir.mirena@gazetaexpress.com ■ Editoriale: Artan Muhaxhiri artan.muhaxhiri@gazetaexpress.com
 ■ Politikë: Leonard Kerçuku leonard.kercuku@gazetaexpress.com ■ Nacionale dhe siguri: Jeton Musliu jeton.musliu@gazetaexpress.com
 ■ Ballkanexpress: Faton Raçi faton.raci@gazetaexpress.com ■ Bota: Arsim Buxhovi arsim.buxhovi@gazetaexpress.com
 ■ Arte: Arben Idrizi arben.idrizi@gazetaexpress.com ■ Sport: Valdet Hasani valdet.hasani@gazetaexpress.com
 ■ Fotografia: Visar Kryeziu visar.kryeziu@gazetaexpress.com
 ■ Drejtore e marketingut: Vjollca Musa, marketing@gazetaexpress.com redaksia: info@gazetaexpress.com tel: 038 76 76 76; fax: 038 76 76 78;
 ■ Shtypi: Roto Print; botues: MediaWorks.

Fjalët e Botës

“ Jam thellësisht e nderuar që ta udhëheq këtë vend që e dua shumë ”



JULIA GILLARD,
Zëvendësja e Kryeministrit të deritashëm australian, Kevin Rudd, është bërë Kryeministria e parë e Australisë, dhe liderja e parë shtetërore në historinë e shtetit.

“ Paniku ishte i menjëhershëm. ”



MARCELO CARDONA,
Pasaqjer në trenin e shpejtësisë së madhe, i cili u aksidentua në Platja de Castelldefels afër Barcelonës, me çrast vdiqën 12 persona. Afro 30 vetë që po shkonin në një festival, u përpoqën t'i kalonin binarët në vend se ta shfrytëzonin nënkalimin, por u goditën nga treni.

“ Shyqyr që përfundoi! ”



SPEKTATOR,
Tenisti amerikan John Isner ka fituar ndaj francezit Nicolas Mahut me rezultat 70:68 në gejma, në setin e pestë të ballafaqimit epik që zgjati tri ditë në Wimbledon. Ky meç ka hyrë në histori si më i gjatë i të gjitha kohëve - gjithsej 11 orë e 5 minuta.

MOTI	PRISHTINË
	Sot Max: 20 °C Min: 11 °C
	Nesër Max: 20 °C Min: 12 °C



Armand **Shkullaku**

Shamitë, një vendim i nxituar

Një udhëzim administrativ i Ministrisë së Arsimit mbi ndalimin e mbajtjes së uniformës fetare në shkollat e mesme e të larta, ka shkaktuar jo pak tension në shoqërinë kosovare.

Ky tension, më shumë se sa produkt i një konflikti shtet-religjion, apo i një konflikti brenda shoqërisë kosovare, ka ardhur si pasojë e nxitimit dhe e papjekurisë së autoriteteve për të lëshuar udhëzimin në fjalë. Ndalimi i përdorimit të simboleve fetare në shkolla është një vendim tepër i ndjeshëm që nuk mund t'i vihet kapak me një fjalë në Nenin 4 të Kodit të Mirësjelljes: “Ndalohet bartja e uniformës fetare”. I shpallur në këtë mënyrë, udhëzimi qeveritar e ka kapur të papërgatitur shoqërinë kosovare, dhe për pasojë, edhe reagimet - si protesta agresive e besimtarëve myslimanë ditë më parë - mund të jenë të papritura dhe të paparashikuara. Shumë vende europiane me demokraci të konsoliduar dhe ekonomi të fuqishme, i kanë paraprirë iniciativave të tilla delikate që prekin direkt në besimin e një pjese të popullsisë, me debate publike, fushata sensibilizuese, angazhim të juristëve e shoqërisë civile, dhe vetëm pas gjithë këtyre etapave kanë vendosur (jo me udhëzim, por me ligj në Parlament) ndalimin e përdorimit të simboleve fetare në shkolla. Në Kosovë nuk pati asnjë debat, dhe si rezultat, një vendim kaq i rëndësishëm rrezikon të keqkuptohet, të politizohet, të shfrytëzohet nga ekstremistët dhe t'i lërë në errësirë arsyet për të cilat, në një shtet laik, simbolet fetare duhen lënë tek dera e shkollës.

Personalisht mendoj që laiciteti në shkolla duhet respektuar dhe simbolet fetare duhen ndaluar të shfaqen në mjediset e edukimit publik. Besimi qëndron në kokë dhe jo mbi kokë si etiketë. Në mjaft vende europiane një gjë e tillë është bërë me kohë dhe sot debati më i madh ka të bëjë me ndalimin e përdorimit të burkës nga gratë myslimane në hapësira publike, rrugë, parqe, qendra tregtare, plazhe, etj., për arsye të sigurisë e rendit publik.

Por, a është udhëzimi i Ministrisë së Arsimit mënyra më e mirë për ta bërë një gjë të tillë? A mundet një nen i thjeshtë t'i vërë vulën përfundimtare një çështjeje kaq të debatueshme dhe për më tepër në një vend të prapambetur, me nivel të lartë varfërie, me mungesë të kulturës demokratike, ku gratë janë ende të diskriminuara dhe ku krimi, trafikimi e korrupsioni kanë vënë në dyshim të madh vetë moralin e shoqërisë? Sigurisht që jo. Nëse në vendet europiane janë dashur muaj e vite për të përgatitur shoqërinë për vendime të tilla, në Kosovë do të duhej shumë më tepër.

Vënia e besimtarëve myslimanë përballë një fakti të kryer, pa u dhënë më parë të drejtë ta diskutojnë atë, është vetëm njëra anë e problemit. Udhëzimi i Ministrisë paraqet edhe shumë defekte të tjera, pasojë e mungesës së

profesionalizmit dhe kushtëzimit politik. Nga aspekti profesional, ky vendim është shumë evaziv, me gjuhë të paqartë dhe me plot boshllëqe. Ai ndalon uniformën fetare, por jo simbolet fetare. Nuk përcakton çfarë quhet “uniformë fetare”, e çfarë “veshje”. Sipas këtij udhëzimi, një nxënëse nuk mund të mbajë shaminë në kokë, por një tjetër mund të shkojë në klasë me kryq në qafë, që është simbol dhe jo uniformë fetare, e plot shembuj të tjerë. Po kështu, udhëzimi u drejtohet nxënësve të shkollave të mesme e të larta, duke lënë të hapur mundësinë që nxënësit e shkollave fillore publike të mbartin uniformë fetare. Të gjitha këto mangësi janë pasojë e konceptimit të një çështjeje kaq të rëndësishme si diçka që duhet hequr qafe, pa menduar pasojat. Lehtësia e shumë vendimeve të Qeverisë është reflektuar edhe mbi një temë kaq delikate, që mund të prodhojë tensione të paparashikueshme sociale.

Një nga ligjet që u bë i famshëm në Europë është ai francez i shkurtit 2004, mbi ndalimin e simboleve fetare në shkolla. Ligji që kaloi me 494 vota pro dhe 36 kundër në Parlamentin francez, ndalon që në shkolla, kolegje e gjimnaze publike, të mbahen shenja ose veshje nëpërmjet të cilave nxënësit manifestojnë qartë përkatësinë fetare. Në sendet e ndaluara përfshihen apriori hixhabi mysliman, kapa hebreje, kryqet e mëdhenj, etj., por lejohen simbole diskrete si kryqet e vegjël, ylli i Davidit, apo dora e Fatimës. Ligji francez është i zbatueshëm brenda mjedisve shkollorë publike vetëm për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, dhe jo për studentët apo prindërit e nxënësve kur paraqiten në shkollë. Në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës nuk ka asnjë shpjegim të qartë dhe përshtypja që krijohet është se po penalizohen vetëm besimtarët myslimanë, duke devijuar kështu debatin nga rëndësia e laicizmit në shkolla në atë të distancimit nga islami.

Vendimi në fjalë vuan edhe nga kushtëzimi politik. Në vend të një ligji të miratuar në Parlament ku shumica, hapur dhe me përgjegjësi, do të merrte përsipër këtë reformë në shkollat publike, u zgjodh një mënyrë dredharake, një fjalë e fshehur në një nen të rregullores disiplinore. Ndalimi i simboleve fetare në shkolla është një akt politik, pjesë përbërëse e projektit në të cilin kërkohet të ecë shoqëria kosovare. Tekstet dhe doktrinat fetare kanë vlerë për besimtarët përkatës, por ato nuk mund të jenë normë sociale e politike. Nëse Qeveria druhet se humb vota duke marrë përsipër një projektligj të tillë, mënyra që ka zgjedhur dëmton gjithë shoqërinë. Ajo duhet me kurajë ta tërheqë udhëzimin sakat, të iniciojë një debat kombëtar dhe të paraqesë një projektligj serioz për ndalimin e çdo lloji simboli fetar në shkollat publike.

» Pa kundërshtimin qytetar e shoqëror ndaj këtij procesi dhe pa mosbindjen e avokatëve ndaj gjykatësit të EULEX-it, ky proces pa dyshim se nuk do të mbaronte me kaq dhe kështu.

Një gjyq policor pas një policie ndëshkuese



Albin Kurti

Në orën 10:00 të mëngjesit do të fillonte gjykimi. Qysh në 07:30 më dërguan në gjykatë. Njësia speciale me maska i terrorizoi qytetarët e rastit. Nuk pati kalimtarë në rrugët 'Luan Haradinaj', 'UÇK' dhe 'Ilir Konushevi' që nuk u shqetësua dhe instiktivisht nuk lëvizti një a më shumë hapa larg prej cepit të rrugës. Furgonat dhe xhipat e policisë të shoqëruar me sirenat alarmuese dhe boritë shurdhuese të tyre, fluturuan në drejtim të Gjykatës së Qarkut. Gjithandej pati këmbësorë që gati sa nuk u shtypën e makina tjera që për pak nuk u goditën nga konvoji policor. Ky shqetësim i publikut bëhej për ta mundësuar gjykimin e dënimit tim si shqetësues i publikut.

U gëzova shumë kur nuk i pashë avokatët. Mbrojtja e tyre për mua do t'i ndihmonte sulmit kundër meje. Përkundër faktit që unë isha aty, ata vazhduan të mos vinin. Meskenar të përgatitur dhe me regjisorin Ferdinando Buatier de Mongeot të pranishëm, ishte shumë e rëndësishme që të mungonin aktorët. Padëgjueshmëria kur nuk jep rezultate, kjo nuk ngjan për shkak të karakterit të saj, por për shkak të përmasës saj. Padëgjueshmëria kolektive dhe e përgjithshme gjithmonë ka sukses. Gjykatësi ndërkombëtar de Mongeot sigurisht që nuk u befusua. Kjo ishte seanca e njëmbëdhjetë me radhë dhe e para me mua në të. Në dhjetë seancat paraprake ishte entuziazmuar atëherë me të rrallë kur kishte arritur të sjellte avokatë në gjykatore, për t'u zhgënjyer shpejt më pas nga dorëheqjet e tyre. Midis gjykatësit të EULEX-it që ngulmonte në këtë proces dhe dhjetëra mijëra nënshkrimeve të qytetarëve që i bashkoheshin peticionit secilën ditë, avokatët nuk kishin pasur shumë dilema se çfarë duhet të zgjedhnin.

EULEX-i u pat diskredituar shumë nga ky proces dhe ai duhej mbyllur disi sa më parë. Gjykatësi i EULEX-it e kishte vetëm një mundësi para vetes: të hiqte dorë nga akuzat e parë për të cilën parashihej dënimi prej një deri në dhjetë vjet dhe, kësaj, gjykimi të vazhdonte pa avokat. Ligji në Kosovë nuk lejon proces pa avokat nëse i pandehuri mund të dënohet me më shumë se tetë vjet. Kjo është arsyeja e reduktimit drastik të padisë nga ana e gjykatësit ndërkombëtar. Shihej se ai si profesionist kishte siklet të vazhdonte me këtë padie absurde dhe me bazë të dobët ligjore, mirëpo vendimtare për ta hequr akuzën e parë ishte nevoja që ky proces të mbyllet pa avokat dhe sa më shpejt, e jo ndonjë ndjenjë e gjykatësit për drejtësi. Porsa filloi seanca gjykatësi de Mongeot njoftoi që prokurori Ali Rexha kishte diçka për të thënë. Dhe Ali Rexha foli: hiqet edhe akuzat e parë, tha ai. Më herët prokurori Rexha e kishte hequr akuzën e tretë. Gjithsesi një drejtësi e çuditshme kjo: unë nuk shkoja në seanca e ata i zvogëlonin akuzat! Me heqjen e akuzës për 'tentim të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm', vrasjet dhe plagosjet më 10 shkurt të vitit 2007 nga ana e policëve rumunë të UNMIK-it u bënë absolutisht kriminale dhe absolutisht të pajustificueshme.

Se këtë akuzë në të vërtetë nuk e kishte hequr prokurori por vetë gjykatësi, e dëshmoi pa dashje pikërisht prokurori Rexha. Në fjalimin e tij përmbyllës ai nisi të më akuzojë edhe në lidhje me akuzën e parë prej të cilës kishte hequr dorë në fillim të seancës! Ali Rexha e lexoi fjalimin përmbyllës të cilin e kishte shkruar para se 'ky' ta hiqte akuzën e parë. Në këtë situatë groteske, krejt çfarë mund të bënte Ferdinando Buatier de Mongeot ishte të skuqej sa më pak.

Në arsyeshmërinë e vendimit për dënimin me 9 muaj burg, de Mongeot nuk kishte mundur t'i përdorte fare dëshmitarët e prokurorisë. Policët Besart Ahmeti, Kristë Gjokaj dhe Ismet Hajdini dëshmuar në favor timin. Nga lista e gjatë e dëshmitarëve ishin përzgjedhur vetëm tre sosh, por edhe këta s'i hynë në punë de Mongeotit. Unë nuk kisha fare nevojë t'i demaskoja e zhvlerësoja këta dëshmitarë të prokurorisë. Pas dëshmisë së tyre ishte gjykatësi ndërkombëtar ai i cili i mori në pyetje duke u përpjekur t'i diskreditojë për shkak të shpërputhjes ndërmjet dëshmisë së tyre në shkurt të vitit 2007 dhe tash. Aq i zellshëm ishte ky gjykatës kundër dëshmitarëve të prokurorisë (që, në fakt, u bënë dëshmitarë të mbrojtjes), sa që kur i thashë që propozoj që ai ta ndërrojë vendin me prokurorin, sërish nuk i mbeti gjë tjetër vetëm të skuqej sa më pak. Dëshmitarëve njëmend nuk u përputheshin deklaratat, por atyre nuk u janë përputhur as deklaratat e dhjetorit të vitit 2007 me ato të shkurtit të atij viti, e lëre më

me këto të fundit. Ishte e qartë se policët kosovarë kishin qenë nën trysni të tmerrshme nga hetuesit e UNMIK-it menjëherë pas 10 shkurtit 2007, andaj ata nënshkruan ato deklaratash të cilat vetëm disa muaj më vonë nuk ishin në gjendje as t'i njohin se çfarë përmbajnë se ku e ku t'i përsërisin. Për më tepër, këta policë dëshmitarë më 14 qershor 2010 treguan se si ata do të mund të ishin edhe një herë dëshmitarë të prokurorisë, por kësaj radhe në një proces tjetër që ende mungon – ai kundër policëve rumunë të UNMIK-it. Policët dëshmitarë rrefyesh se si ndërhyrja më 10 shkurt 2007 ishte e lidhur me njoftimin që ia kishte kumtuar ShPK-së një zyrtari i lartë i UNMIK-it po atë ditë në mëngjes, duke u thënë që kanë informata të sigurta nga shërbimi i tyre inteligjent që demonstruesit do ta sulmojnë ndërtesën e UNMIK-it. Prandaj ishte sjellur i gjithë ai armatim në sheshin 'Nëna Tereze': për t'u përdorur, jo për t'u ekspozuar.

Dënimi prej 9 muajsh m'u shqiptua sa për të qenë në rregull librat e brendshëm të OKB-së dhe si mbulesë për persekutimin dhe paraburgimin e mëhershëm gjatë vitit 2007 në kohën e UNMIK-it. Kësaj, doli që Prokuroria Speciale e EULEX-it, e cila merret me krimin e organizuar, terrorizmin, krimet e luftës e të ngjashme, e paska marrë për trajtim të ngutshëm një rast të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrës të tyre zyrtare! E këtu ishte kjo akuzat e dytë që mbeti në fund. I gjithë ky angazhim e zell u bë për një këso akuzat fare minore siç e cilësoi edhe vetë de Mongeoti. Vendimi e dënimi i tij, pa dëshmitarë e pa prova materiale, u bazua vetëm në një xhirim të demonstratës, edhe ashtu jo aq i përshtatshëm pasi që unë as që shihesha në masën e demonstruesve!

Akuzat 2 gabimisht pohonte se më 10 shkurt 2007 policia e kishte mbrojtur pronën institucionale, dhe që unë i kisha penguar ata për ta bërë këtë. Kordonit policor nuk ishte vënë më 10 shkurt para pronës institucionale për ta mbrojtur atë, por ai ishte vendosur në mes të rrugës, duke e bllokuar itinerarin e marshimit tonë paqësor. Ne e kishim shpallur këtë itinerar mjaft kohë më parë, dhe unë e kam përsëritur atë ditë në fjalimin tim. Policia e ka ditur saktësisht se ku do të marshonim më 10 shkurt, dhe u pozicionua në mes të kësaj rruge, duke e bllokuar atë. Kjo do të thotë se kordoni u formua në *orvatje për të bllokuar demonstratën tonë paqësore*, ose "për të penguar protestuesit që të vazhdonin më tej" (siç edhe thuhet në faqen 2 të padisë). Ajo çfarë policia ka bërë atë ditë ishte një veprim për të shtypur një protestë jo të dhunshme dhe për të shkelur të drejtat tona për lirinë e tubimit, protestës paqësore dhe të shprehjes, të konfirmuara edhe nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Oya Ataman kundër Turqisë*. Gjykatësi de Mongeot u bind që është kështu, prandaj ai u distancua nga ligjshmëria e kordonit policor në mes të rrugës, dhe më shpall i fajtor jo pse kordoni ka qenë aty sipas ligjit apo me të drejtë, por pse policët megjithatë e kanë pasur për detyrë formimin e këtij kordonit bllokues qoftë ai edhe i padrejtë e i paligjshëm! Dënimi prej 9 muajsh në bazë të ligjit është dashur të jetë së paku një vit. Por, megjë me atë rast do të duhej të më çojnë në burg që t'i mbaj edhe një muaj e gjysmë shtesë, ndërkohë që Lëvizja VETËVENDOSJE! kishte paralajmëruar demonstratë për datën 21 qershor, gjykatësi e përdori nenin 66 për zbutje të dënimit nën minimumin e paraparë dhe më liri. Ashtu siç e kishte ky proces (ri) fillimin dhe ecurinë e tij kryekëput politike, as fundi i tij s'ishte tjetër për nga karakteri. Politikisht më arrestuan e izoluan, politikisht edhe më liruan. Nuk e quan EULEX-i kot veten operacion për menaxhimin e krizave dhe jo institucion i drejtësisë.

15 shkurti i këtij viti u pat caktuar si ditë e rifillimit të gjyqit kundër meje. Atëbotë ishin paraparë tetë seanca gjithsej me data specifike dhe me një dizinë dëshmitarësh, që të gjithë policë. Në fund mbeti vetëm një akuzë dhe u bë vetëm një seancë shpejt e shpejt (ku gjykatësi nuk dihej nëse më shumë kishte hall karakterin politik të fjalimit tim apo kohëzgjatjen e tij). Pa kundërshtimin qytetar e shoqëror ndaj këtij procesi dhe pa mosbindjen e avokatëve ndaj gjykatësit të EULEX-it, ky proces pa dyshim se nuk do të mbaronte me kaq dhe kështu. Deklaratat e mëhershme të zyrtarëve ndërkombëtarë si ajo e zëdhënësës së EULEX-it, Kristina Herodes, se unë duhej ta dëshmoja pajafësinë në gjyq (gjë që paraqet shkelje të rëndë dhe prejudikim) ose ajo e Pieter Feithit në AUK se unë duhej të përgjigjesha për mbrapshtitë (ang. *misdeeds*) e mia (e që sërish paraqet shkelje sepse prejudikim) nuk kanë treguar vetëm nervozizmin e tyre.

WWW.IPKO.COM

TELEVISIONI DIGITAL



Aktivizimi prej 20 EURO, tani për vet më 5 EURO!

Nxtoni, oferta sht e limituar.



NË SHTËPI

Politikë

REDAKTOR: LEONARD KERQUKI
E-MAIL: LEONARD.KERQUKI@GAZETAEXPRESS.COM
TEL: 038 76 76 76 FAX: 038 76 76 78

Gati për Samit

Presidenca e Kosovës ka njoftuar se janë bërë të gjitha përgatitjet për mbajtjen e Samit të Prizrenit, ku do të marrin pjesë presidentët e tri vendeve fqinje - Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë. Siç njofton Zyra e Presidentit, temë kryesore e takimit të katër presi-

dentëve do të jetë bashkëpunimi rajonal. "Me organizim të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës do të mbahet mini-samiti në Prevallë të Prizrenit. Janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e këtij takimi të liderëve të rajonit, ku të ftuar

janë Presidenti i Shqipërisë Bamir Topi, ai i Maqedonisë, Georgi Ivanov dhe Presidenti i Malit të Zi, Filip Vujanovic", thuhet në njoftimin e Presidencës. Samiti i Prizrenit do të zgjasë prej të premtes deri të dielën dhe mbahet në fshatin turistik Prevallë.

»LajmeShkurt

Ndarazi në BE



Ulrike Lunacek, hartuese e rezolutës për Kosovën të miratuar nga Komiteti për Politikë të Jashtme i Parlamentit Europian, ka thënë se rruga e Kosovës dhe e Serbisë drejt familjes europiane është si dy shtete të pavarura. "Mendoj që ardhmëria e Serbisë dhe e Kosovës qëndron në BE dhe shpresoj se në të ardhmen kufijtë, dallimet etnike ose e kaluara e historisë mos të jenë aq të rëndësishme. Kjo është rruga të cilën ne të gjithë po e ndjekim. E në këtë rrugë ne duam që të shohim Serbinë dhe Kosovën si shtete të pavarura", ka thënë Lunacek.

Flasin për liberalizim



Kryetari i Partisë Liberale të Kosovës, Gjergj Dedaj po qëndron për një vizitë pune në Bruksel, ku është prituri nga Komisionerja për Punë të Brendshme të BE'së, Cecilia Malmstrom, më të cilën ka biseduar për çështjen e liberalizimit të vizave dhe agjendën e proceseve integruese të Kosovës dhe të rajonit në BE. Nga ana e saj, siç theksohet në një komunikatë të PLK'së, Komisionerja Malmstrom ritheksoi se institucionet e BE'së e ndihmojnë Kosovën dhe e përcjellin për se afërmi zhvillimin e proceseve demokratike dhe të sundimit të ligjit në Kosovë - si faktor kryesor për stabilitet në vend dhe në tërë rajonin.

Pavarësia nuk

Gjatë bisedimeve mes Prishtinës dhe Beogradit nuk do të hapet çështja e statusit e as ajo e ndarjes. Kjo është porosia që ka sjellë të enjten në Prishtinë David Ledington, Ministër për Europë i Mbretërisë së Bashkuar. Ai tha se Londra dhe zyrtarët në Bruksel po angazhohen që Bashkimi European të dalë me qëndrim të përbashkët për opinionin e GJND'së.

Shpend Limoni

shpend.limoni@gazetaexpress.com

PRISHTINË 23 MAJ – Autoritetet kosovare dhe ato të Serbisë nuk do të diskutojnë për statusin gjatë bisedimeve që do të fillojnë, pasi Gjykata Ndërkombëtare ta shpallë opinionin këshillëdhënës për pavarësinë e Kosovës.

Kështu ka deklaruar David Ledington, Ministër për Europë i Mbretërisë së Bashkuar të enjten në Prishtinë, duke theksuar se pavarësia është çështje e mbyllur.

"Qeveria e re britanike do të mbetet e vendosur në përkrahjen e saj për pavarësinë e Kosovës dhe në kundërshtimin e ndarjes apo të rihapjes së çështjes së statusit", ka thënë Ledington pas takimit me

Presidentin e Kosovës, Fatmir Sejdiu.

Ajo çka do të ndodhë pasi GjND ta japë mendimin për ligjshmërinë e pavarësisë është fillimi i bisedimeve për çështje praktike.

"Shpresoj se opinionin e GjND'së do të na japë mundësinë që të ecim përpara e jo të angazhohemi në debate për gjërat të cilat janë vendosur. Kosova është e pavarur, por jemi për një dialog mes Kosovës dhe Serbisë për çështje praktike, që prekin jetën e qytetarëve të zakonshëm në të dyja vendet", ka thënë Ministri britanik.

Ai ka përmendur tregtinë, lëvizjen e njerëzve dhe çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me integrimin në Bashkimin European si tema që



mund të bisedohen mes dy vendeve.

Ledington ka thënë se vendi i tij dhe disa zyrtarë të lartë të BE'së janë duke u angazhuar që Brukseli të flasë me një zë pas shpalljes së opinionit të GjND'së.

"Pavarësia e Kosovës është

një fakt i etabluar dhe nuk do të ketë kthim prapa nga kjo. Ajo çka Britania është duke bërë, është se jemi duke u përgatitur me partnerët europianë dhe baroneshën Ashton, Komisionerin Fule dhe institucionet europiane për atë që ne presim që të jetë një

» EULEX të përforcohet

Ministri britanik ka komentuar edhe rreth mundësisë së arrestimeve të paralajmëruara nga EULEX'i dhe rezultateve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. "Unë mendoj se është me rëndësi që EULEX'i të ketë sukses. Pata një bisedë me Yves de Kermabon këtë mëngjes për EULEX'in dhe njëra nga mesazhet që unë do t'i përcjell në Londër është se duhet të mendojmë më shumë në Europë se si ta përforcojmë

misionin e EULEX'it dhe profilin e EULEX'it në Kosovë, përfshirë në veri të Kosovës, ku është evidente se EULEX'i ka hasur në vështirësi", ka thënë ai. Sipas Ledington, Kosova do t'i ketë më mirë punët nëse vazhdon beteja kundër korrupsionit. "Do të jemi më të suksesshëm në tërheqjen e investimeve në këtë vend, nëse ka stabilitet politik dhe nëse ka mbështetje të qartë kudo për sundim të ligjit dhe për luftën kundër korrupsionit", ka thënë ai.

Presidenti Sejdiu, ndërkaq, nuk ka komentuar rreth deklarimeve të përfaqësuesit të BE'së, Pieter Feith, për dorëheqje të ministrave që janë duke u hetuar. "Çështja e ngarkesës dhe shkarkesës nuk është në kompetencat e Presidentit në këtë pjesë që ju e lexoni. Është çështje e urgjencës time që proceset që kanë të bëjnë me pushtetet e ndara të jenë të ndara dhe të paimpluara nga politika dhe të dalë rezultat në bazë të provave", ka thënë ai.

Falënderimi britanik

Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, ka marrë një letër nga Kryeministri i Mbretërisë së Bashkuar, David Cameron, me anë të së cilës ai e falënderon kreun e vendit tonë

për letrën e urimit me rastin e zgjedhjes së tij në postin e Kryeministrit. Në këtë letër, Kryeministri Cameron shpreh mbështetjen e fuqishme të Mbretërisë së

Bashkuar për Kosovën dhe ambicien e saj për t'u bashkuar me Bashkimin Europian dhe NATO'n si dhe konfirmon angazhimin për të punuar mbi progresin e bërë që nga

pavarësia. "Pres për të zhvilluar më tej marrëdhëniet e forta në mes të dy vendeve tona", thuhet në letrën e Kryeministrit britanikë drejtuar Shefit të Shtetit.



K preket



FOTO: ATOHE MULLA

përgjigje e përbashkët e BE'së kur opinionin i GjND'së të shpallet", ka thënë ai.

Leddington ka thënë se Britania e Madhe do ta mbështesë Kosovën në ambicien e saj për integrim në Bashkimin Europian dhe në NATO.

Presidenti Sejdiu ka kërkuar që bashkësia ndërkombëtare të shtojë presionin ndaj Beogradit për të ndryshuar qasjen ndaj Kosovës. Ai është shprehur i bindur që opinionin i GjND'së do të jetë në favor të Kosovës.

"Mendimi këshillëdhënës i GjND'së nuk mund të jetë kundër argumenteve të lirisë së një populli", ka thënë Sejdiu.

Ministri britanik, para takimit me Sejdiun, është takuar me Ministrin Skënder Hyseni, ndërsa Kryeministri Thaçi ka shtruar një drekë për të.

Leddington ka thënë se Serbia nuk mund të integrohet në Bashkimin Europian me raporte ar-

miqësore ndaj Kosovës.

"Ne jemi në një proces shumë të hershëm të integrimi evropian të Serbisë. Mendoj se është e vështirë që Serbia të integrohet në BE nëse ka gjendje armiqësie mes saj dhe Kosovës. Në këtë fazë është e rëndësishme të thuhet atë që ne në Londër po themi dhe vendet tjera anëtare po i thonë Beogradit. Ne ju duam në BE, por le të bisedojmë seriozisht se si ju do ta bëni këtë", ka thënë ai.

"Në Europën modern ka mënyra paqësore për të zgjidhur problemet me fqinjët. Presim që liderët serbë do të bisedojnë për këtë me ne. Nuk e di sa vjet do të zgjasë kjo, por një ditë kufiri mes Kosovës dhe Serbisë do të jetë si ai i Belgjikës dhe Luksemburgut". Ministri britanik ka qëndruar në Kosovë edhe në mbështetje të procesit të kthimit të personave të zhvendosur. Britania e Madhe do të mbështesë projekte për kthimin e serbëve në rajonin e Prizrenit.



FOTO: JETMIR IDRIZI

Pastaj bisedimet >>

Njëherë njohja

Aleanca Kosova e Re thotë se bisedimet teknike me Serbinë nuk duhet të fillojnë, përderisa Beogradi nuk e njeh shtetin e Kosovës. Ibrahim Makolli, në një konferencë për media, të enjten, ka lëshuar edhe shumë kritika në adresë të Qeverisë.

Faton Ismajli

faton.ismajli@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 24 QERSHOR –

Aleanca Kosova e Re ka dhënë propozimin e saj për bisedimet teknike mes Prishtinës dhe Beogradit, që pritet të fillojnë menjëherë pasi Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të deklarohet rreth ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Nënkyetari i kësaj partie, Ibrahim Makolli, të enjten në një konferencë për media, tha se këto bisedime nuk duhet pranuar nga pala kosovare, përderisa Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës.

"E para, Serbia duhet të njohë Kosovën. E dyta, nuk duhet të negociohet statusit politik. Dhe e treta, nuk duhet të diskutohet ndarja e Kosovës", ka thënë Makolli.

Ai ka kritikuar autoritetet e Prishtinës, të cilët kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të negociuar me Serbinë pa kushte. "Është befasues nxitimi i disa zyrtarëve institucionalë,

të cilët kanë theksuar se janë të gatshëm për bisedime. Kjo është shqetësuese, kur dihet se pikërisht këta që nguten sot janë ata të cilët gjatë negociatave në Vjenë e kanë sakatosur Kosovën", ka shtuar Nënkyetari i AKR'së.

Ibrahim Makolli, të enjten, ka hedhur edhe shumë kritika në adresë të Qeverisë së Kosovës, veçanërisht ka goditur Ministrinë e Punëve të Brendshme që udhëhiqet nga Bajram Rexhepi.

Ai tha se, përveç ministrit, komplet hierarkia e MPB'së udhëhiqet me ushtrues detyre.

“E para, Serbia duhet të njohë Kosovën. E dyta, nuk duhet të negociohet statusi politik. Dhe e treta, nuk duhet të diskutohet ndarja e Kosovës.”

Ibrahim Makolli, Nënkyetar i AKR'së

"Shtylla më e ndjeshme në vend - ajo e sigurisë - e tëra është e udhëhequr nga ushtrues detyre", ka thënë Makolli.

"Sekretari i Përhershëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, Kryeshafi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës, Drejtori i Qendrës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim..., të gjithë këta resorë udhëhiqen me ushtrues detyre", ka shtuar ai.

Ky, sipas tij, është veprim shkatërrues për Kosovën.

"Shumica e institucioneve të vendit tash e shumë kohë, në kundërshtim me ligjet në fuqi, udhëhiqen nga ushtrues detyre, që paraqet veprime shkatërruese për funksionimin e sistemit shtetëror".

Partia e Behgjet Pacollit, gjithashtu, ka kundërshtuar emërimin e Enver Rrustemit në pozitën e ushtruesit të detyrës së Kryshefit të Inspektoratit të Policisë.

Rrustemi, në zgjedhjet e nëntorit, me flamurin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës garoi për Kryetar të Vitisë.

"Me këtë emërim Ministri Rexhepi ka bërë dy shkelje: e para, sepse emërimi është bërë në kundërshtim me ligjin në fuqi, dhe e dyta, sepse në krye ka emëruar një anëtar të një partie politike, çka rrit dyshimin për paanësinë gjatë kryerjes së detyrës", ka thënë Ibrahim Makolli.



Marrëveshje me Slloveninë

Zyrtarët e Kuvendit të Kosovës kanë nënshkruar të enjten në Lubjanë Memorandumin e bashkëpunimit me Kuvendin Kombëtar të Sllovenisë, ku parashihet shkëmbimi i përvojave dhe ekspertëve në fushën legjislativë.

Gjatë qëndrimit në Slloveni, Sekretari i Kuvendit të Kosovës, Ismet Krasniqi dhe homologu i tij slloven, Mojca Prelesnik, nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit, i cili nuk parasheh obligime financiare për asnjërin shtet.

“Brenda kornizës së projektit, ekspertët nga Asambleja Nacionale e Sllovenisë kanë hartuar disa propozime që lidhen me buxhetin dhe menaxhimin financiar, bibliotekën dhe arkivin, dokumentacionin dhe regjistrimin e postës, dhe

mbi të gjitha organizimin e një administrate të qëndrueshme dhe të pavarur si kusht jetik për kualitetin e çdo kuvendi parlamentar”, thuhet në njoftimin e Kuvendit. Kjo marrëveshje do të jetë në fuqi deri më 31 dhjetor 2010



FOTO: FISNIK DOBRECI

TELASHE ME DEPUTETË

Zyrtarë të lartë kosovarë, duke mos respektuar procedurat e udhëtimeve zyrtare, po shkaktojnë probleme nëpër aeroportet ndërkombëtare. Prandaj, Ministri Hyseni ka kërkuar nga Kryeministri Thaçi që të vihen rregulla për disiplinimin e zyrtarëve që posedojnë pasaporta diplomatike.

Valmir Klaiqi

valmir.klaiqi@gazetaexpress.com

Prishtinë, 24 qershor —

Ministra, deputetë dhe zyrtarë tjerë të lartë të Republikës së Kosovës ende nuk janë mësuar t'i respektojnë procedurat ligjore kur udhëtojnë zyrtarisht jashtë vendit.

Disa herë ka ndodhur që zyrtarë shtetërorë që posedojnë pasaporta diplomatike të mbahen me orë të tëra nëpër aeroporte ndërkombëtare, për shkak se nuk kanë pasur viza apo nuk i kanë njoftuar paraprakisht vendet nikoqire ose ambasadat e Kosovës.

Deputetët Ismet Beqiri, Haki Shatri dhe Myzejene Selmani, para disa muajsh, janë zënë në flagrancë nga Policia e Francës dhe janë mbajtur për disa orë në Polici për shkak se kishin dalë jashtë aeroportit përderisa nuk kishin viza Shengen.

“Ishim duke u kthyer nga SHBA-të për në Kosovë dhe kis-

him një ndërrim aeroplani në Paris për t'u nisur pastaj për në Prishtinë. Ne kishim pasaporta diplomatike, por siç e dini në to duhet të kemi viza sepse nuk kemi ende marrëveshje me shtetet që të mund të udhëtojmë me këto pasaporta pa viza. Ne kishim viza për Amerikë dhe disa prej nesh kishim edhe Shengen viza. Pasi kishim disa orë kohë derisa të nisemi për Kosovë, thamë të dalim pak për të shëtitur në Paris. Rreth 100 metra në dalje të aeroportit jemi ndalur nga policia, të cilët na kanë kërkuar dokumentet. Tre kolegët tanë, Ismeti, Hakiu dhe Myzejenja nuk kishin vizë Shengen dhe policia i mori në ndalesë”, tregon për Express në kushte anonime njëri nga deputetët që ishte pjesë e delegacionit.

“Policia as nuk ka dashur të dëgjojë arsyetimin tonë se ata që i morën janë deputetë dhe kanë pasaporta diplomatike. Shkuam në aeroport dhe pritëm rreth dy orë te policia aty, por nuk i lëshu-

an. Na thanë se nuk kanë asnjë njoftim për ndonjë vizitë deputetësh në Paris. Neve na erdh koha për të fluturuar dhe u nisëm për Prishtinë, ndërsa kolegët tanë mbetën në polici”, rrëfen deputeti kosovar.

Sipas këtij deputeti, Beqiri, Shatri dhe Selmani kishin ardhur në Kosovë rreth 8 orë më vonë, pasi ishin sqaruar të gjitha detajet mes ambasadës së Kosovës në Paris, ambasadës së Francës në Prishtinë dhe Ministrisë së Jashtme të Kosovës.

Ky është vetëm një rast nga shumë të tjerë që e kanë shtyrë Ministrin e Jashtëm Skënder Hyseni ta diskutojë këtë çështje me Kryeministrin Hashim Thaçi dhe kabinetin qeveritar në mbledhjen e fundit, të mërkurën. Ky diskutim ka zgjatur rreth 15 minuta, pa praninë e medieve.

Ministri Hyseni ka kërkuar nga Kryeministri Thaçi dhe kolegët e tij që t'i informojnë të gjithë stafin e lartë që kur të bëjnë vizita zyrtar-

re jashtë shtetit, së pari të shkojnë në MPJ dhe të marrin njohuri bazike për vendin që do ta vizitojnë.

“Ministri Hyseni ka kërkuar që zyrtarët që dalin jashtë vendit së pari ta njoftojnë Ministrinë në mënyrë që të njoftohet ambasada e Kosovës në shtetin nikoqir dhe protokollin i atij shteti. Kur zyrtari paraqitet në Ministri ai do të mund të marrë edhe njohuri bazike për vendin ku po shkon dhe do të informohet për marrëveshjet që Kosova ka me shtetin nikoqir”, ka thënë për gazetën një zyrtar i lartë i Qeverisë, në kushte anonimite.

Në këtë diskutim të mbyllur për media, bëhet e ditur se është kërkuar nga Ministria e Punëve të Jashtme që ta hartojë një rregullore enkas për këtë çështje. MPJ pas themelimit të saj e kishte bërë një njoftim të thjeshtë, ngase atëherë nuk kishte bazë ligjore për rregullore, nëpërmjet të cilit i kishte njoftuar të gjitha institucionet se duhet të njoftojnë Ministrinë e Jashtme për çdo vizitë zyrtare jashtë shtetit.

Qerim Qerimi, këshilltari politik i Ministrin Skënder Hyseni, ka thënë të enjten për Express se për çështjet e brendshme që diskutohen brenda kabinetit qeveritar, nuk mund të prononcohet.

“Nëse nuk ka qenë publike ajo çka është diskutuar në Qeveri, ne

nuk mund ta komentojmë ose të flasim për të”, ka thënë shkurt ai.

Në anën tjetër, anëtari i Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme në Kuvendin e Kosovës, Ibrahim Gashi, ka thënë se e mbështet idenë e Ministrin Hyse- ni për koordinim më të mirë mes zyrtarëve që udhëtojnë jashtë dhe Ministrisë së Jashtme.

“Delegacionet ose individët që shkojnë si përfaqësues të ndonjë institucioni të Kosovës në ndonjë shtet është mirë që ta njoftojnë së pari Ministrinë e Jashtme dhe të kërkojnë asistencë nga ajo për të marrë informacione të bollshme për vendin ku po shkon, në mënyrë që mos të dalë i painformuar te nikoqiri. Kjo është rregull e pashkruar në marrëdhëniet diplomatike mes shteteve. Kjo është edhe pjesë e etikës dhe e kulturës personale si dhe respekt për nikoqirin”, ka deklaruar Gashi.

Sipas tij, çdoherë kur zyrtari që udhëton për vizitë jashtë shtetit nuk e njofton Ministrinë e Jashtme dhe protokollin, gjithmonë dalin probleme.

“Unë nuk di raste konkrete, por as nuk mund të mohoj se ka pasur probleme në këtë aspekt. Për të mos ndodhur gjëra të tilla, atëherë është mirë që të respektohet protokollin, të njoftohet Ministria dhe gjithçka pastaj do të jetë e koordinuar mirë”, ka deklaruar Gashi.

Nacionale

Redaktor: Jeton Musliu • e-mail: jeton.musliu@gazetaexpress.com
tel: 038 76 76 76 fax: 038 76 76 78

Arrestohet për ryshfet

Mitrovicë 24 qershor - Arrestohet një person i dyshuar për shpërdorim të detyrës zyrtare në Mitrovicë. Si vazhdimësi e hetimeve lidhur me rastin e iniciuar me herët në prill të këtij viti, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, Njësia Rajonale Mitrovicë, ka ar-

restuar në mbrëmjen e së mërkurës, N. Ll, me profesion Instruktor për patentë shofer. Sipas policisë, ky person është arrestuar me dyshimin se ka kryer veprën penale "Shpërdorim i detyrës Zyrtare ose autorizimit" nën 339 KPK, duke bashkëpunuar me dy persona tjerë zyrtar të cilët

me datë 14 prill gjithashtu janë arrestuar për rastin e njëjtë. "Me Urdhër të Prokurorit të Prokurorisë Publike Komunale Mitrovicë i dyshuari i lartcekur është dërguar në mbajtje për 48 orë", sqaron policia ndërkohë që hetimet janë duke vazhduar lidhur me këtë rast.

Arrestim për ryshfet

Mitrovicë, 24 qershor - Arrestohet një person i dyshuar për shpërdorim të detyrës zyrtare në Mitrovicë. Si vazhdimësi e hetimeve lidhur me rastin e iniciuar me herët në prill të këtij viti, Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, Njësia Rajonale Mitrovicë, ka arrestuar në mbrëmjen e së mërkurës, N. Ll, me profesion instruktor për patentshoferë. Sipas policisë, ky person është arrestuar me dyshimin se ka kryer veprën penale "Shpërdorim i detyrës Zyrtare ose autorizimit" nën 339 KPK, duke bashkëpunuar me dy persona tjerë zyrtarë, të cilët më 14 prill gjithashtu janë arrestuar për rastin e njëjtë. "Me Urdhër të Prokurorit të Prokurorisë Publike Komunale Mitrovicë, i dyshuari është dërguar në mbajtje për 48 orë", sqaron policia, ndërkohë që hetimet janë duke vazhduar lidhur me këtë rast.

Kërkohet nga Interpoli, arrestohet në Mal të Zi

Podgoricë, 24 qershor - Policia malazeze në pikën kufitare me Kosovën në Kullë ka arrestuar shtetasin kosovar, Burim Delia /29/, ndërsa në pikën kufitare me Bosnjë-Hercegovinën, Shqepan Pole, një shtetase të Sllovenisë, Dijana H. Cvetanovska /39/, për të cilët Interpoli slloven dhe ai gjerman kishin shpallur fletarrest ndërkombëtar. Zëdhënësja e Drejtorisë së Policisë malazeze, Tamara Raleviq, thotë se Cvetanovska në Slloveni akuzohet për vepra penale, kalim ilegal të kufirit shtetëror dhe pjesëmarrje në trafikim me qenie njerëzore.

PËRPLASEN PËR PRONË



FOTO: JETMIR IDRIZI

Isuf Hoti, Adnan Koca dhe Fadil Xani, nga fshati Polac, kanë mbetur të plagosur brenda objektit komunal të Skenderajt. Ata janë përleshur fizikish pas një mosmarrëveshjeje rreth kontraktimit të shitblerjes së një prone. Sipas familjarëve, gjendja e tyre është e mirë. Kryesit e veprës akoma nuk janë kapur.

Lirita Halili

lirita.halili@gazetaexpress.com

SKENDERAJ, 24 QERSHOR - Objekti i komunës së Skenderajt nuk ishte i mbushur me punonjës e zyrtarë komunalë, sikurse herëve të tjera.

Të enjten në vend të tyre, në ndërtesë ndodheshin policë dhe hetues, pas rastit të rëndë që ka ndodhur në orët e hershme të mëngjesit brenda objektit të ndërtesës së Kuvendit Komunal të Skenderajt, me ç'rast Isuf Hoti, Adnan Koca dhe Fadil Xani, nga fshati Polac i Skenderajt, janë plagosur rëndë me armë zjarri.

Në vend ngjarje kanë dalë të gjitha njësitë përkatëse të policisë

“Ata janë mirë. Të paktën kështu na kanë thënë mjekët.”

Familjarët e të plagosurve

dhe prokurori publik i Prokurorisë së Qarkut.

Sipas raportit policor, thuhet se palët e përfshira në rast ishin ngatërruar pas një mosmarrëveshjeje të tyre rreth kontraktimit të shitblerjes së një prone private.

“Në bazë të hetimeve preliminare të policisë, në këtë rast besohet se së paku dy persona të dyshuar, të armatosur kanë shtënë drejt viktimave të tyre pas një përleshjeje fizike brenda ndërtesës së Kuvendit Komunal”, thuhet në njoftimin e policisë.

Më tej sqarohet se për arsye të ekzaminimit të papenguar të vendit të ngjarjes, zyrtarët e kuvendit komunal të Skenderajt janë detyruar të lëshojnë ndërtesën deri në përfundim të mbledhjes së provave dhe ekzaminimit të detajuar të vendit të ngjarjes.

Njëri ndër qytetarët që ndodhej pranë vendit të ngjarjes, i cili des-

hi të mbetet anonim për gazetën, shpjegon se i ka parë vetëm disa punonjës të komunës duke dalë nga xhamat e katit të parë.

“Nuk di asgjë vetëm i dëgjova disa të shtëna armësh dhe kur i pash njerëzit duke dalë prej derës e prej xhamave të objektit”, tregon ai për Express.

Menjëherë pas ngjarjes, të plagosurit janë dërguar në shtëpinë e shëndetit të qytetit për t'u transferuar me urgjencë në repartin e emergjencës në QKUK, në Prishtinë.

“Në bazë të informatave të para nga mjekët kujdestarë, mësohet se dy nga tre të plagosurit janë në gjendje të rëndë”, sqaron Policia e rajonit të Mitrovicës.

Kurse, sipas të afërmeve, të cilët ishin mbledhur para dyerve të Klinikës Emergjente në Prishtinë, gjendja e tyre është e mirë.

“Të paktën kështu na kanë thënë mjekët”, u shprehën ata, dukë mos qenë të gatshëm të japin detaje të tjera për gazetën.

I pyetur për shëndetin e tre të plagosurve, as mjeku i cili ishte kujdestar për ata nuk ishte i gatshëm të jepte ndonjë informacion.

“Nuk dua të flas për media, sepse shumë herë i keni keqpërdorur informacionet e mia”, tha ai.

Përkundër këtyre që ndodheshin në Emergjencë, disa nga familjarët e të plagosurve akoma nuk e dinë që kjo ngjarje ka të bëjë me Isufin, Adnanin dhe Fadilin.

“Gruaja e axhit Isuf bashkë me fëmijët mendojnë që axha ka bërë aksident me makinë.”

Afërdita Hoti

Afërdita, vajza e vëllait të Isufit, shpjegon se gruaja e fëmijët e Isufit nuk dinë që për rastin e komunës bëhet fjalë për të.

“Gruaja e axhit Isuf, bashkë me fëmijët mendojnë që axha ka bërë aksident me makinë”, shpjegon Afërdita për Express.

Ajo thotë që edhe familjarët e Adnanit edhe Fadilit e mendojnë të njëjtën gjë.

“Ju kisha lut, mos shkoni tek shtëpitë e tyre, sepse gjysma e familjarëve të Fadilit ndodhen jashtë Kosovës, kurse të gjysma e të tjerëve nuk dinë asgjë për këtë fatkeqësi”, thotë Afërdita.

Policia e Kosovës ka bërë bastisjen e dy lokacioneve, shtëpive private, në fshatin Klinë të Skenderajt, në kërkim të dyshuarve të këtij rasti.

Identiteti i dy të dyshuarve është i njohur për policinë, ndërsa policia po bën përpjekje të identifikojë vendndodhjen e tyre.

Hetuesit rajonalë të sektorit për krime serioze nga Drejtoria rajonale e Policisë në Mitrovicë janë duke u marrë me rastin.

Admirali në Kosovë

Prishtinë 24 qershor - Komandanti i Forcave të Përbashkëta Aleate të Komandës në Napoli, admiral Mark Fitzgerald vjen sërish në Kosovë për të vizituar Shtabin e Përgjithshëm të KFOR-it. Admirali amerikan, Fitzgerald, do

të takohet me komandantin e KFOR-it, gjeneralin Markus Bentler, nga i cili do të informohet për zhvillimet e fundit në Kosovë. Më pastaj të dy komandantët, në orët e pasdites, do të mbajnë një konferencë të përbashkët për

media. Komanda e Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli (JFC Naples) është një nga komandat ushtarake të NATO-s. Komandanti i Forcave të Përbashkëta në Napoli i raporton Komandantit Suprem të Forcave të

Përbashkëta për Evropë (SACEUR) në Shtabin Suprem të Forcave Aleate për Evropë në Casteau të Belgjikës. Admirali Mark Fitzgerald ka përgjegjësi operative për misonet e NATO-s në Ballkan, Irak dhe

Mesdhe. Ai këtë detyrë e mori më 30 nëntor 2007. Vizitat e admiralit Fitzgerald janë shpeshuar shumë gjatë muajve të fundit. Mesatarisht ai vazhdon të vijë një herë në dy muaj në Kosovë.



FOTO: JETMIRA REXHEPI

Folën ekspertët

Ferki Ibrahim, si i dyshuar për vrasjen e gruas së tij Igballe Llaloshi, bashkë me avokatët dhe trupin gjykues, dëgjo mendimin e ekspertëve lidhur me gjendjen e tij psikike. Ai doli të jetë jo shumë në rregull nga gjendja mendore.

Jetmira Rexhepi

jetmira.rexhepi@hotmail.com

PRISHTINË, 24 QERSHOR – Është zhvilluar edhe një seancë gjyqësore ndaj të akuzuarit Ferki Ibrahim. Ky person akuzohet për vrasjen e gruas së tij, Igballe Llaloshi.

Në seancën e së enjtes është dhënë mendimi i ekspertëve të Klinikës së Psikiatrisë së Prishtinës lidhur me gjendjen psikike të të akuzuarit.

“Ekipi i ekspertëve të Klinikës së Psikiatrisë mbetet në tërësi të konstatimit mjekësor të dhënë për pacientin Ferki Ibrahim”, ka thënë para trupit gjykues ekspertja Nazmije Ibishi, me një ndryshim siç ka thënë ajo, në pikën e pestë.

“I propozojmë gjykatës që pacienti Ibrahim të vuajë një dënim, në kushte penale dhe nëse paraqitet nevoja edhe të shërohet në Klinikën Psikiatrike”, tha ekspertja.

Por, ekspertja Ibishi ka theksuar se aktualisht nuk është nevoja që i akuzuari Ferki Ibrahim të paraqitet për masën e kontrollit psikiatrik.

“Ka mundësi që pacienti Ferki Ibrahim edhe gjatë paraburgimit të ketë nevojë për trajtim mjekësor. Nuk e përjashtojmë që mund të ketë ndonjë krizë akute”, ka deklaruar para trupit gjykues, Ibishi.

Kurse, eksperti Arbër Shala iu ka përgjigjur një varg pyetjesh të avokatit Krasniqi. Eksperti Shala ka thënë se të pacienti Ferki Ibrahim nuk ka vërejtur që ai abuzon me substanca psikoaktive dhe se nuk vërehet efekte organike, ngecje motorike apo abuzim.

“Pacienti i është bërë CT dhe EKG dhe aty është parë se ekziston një strukturë normale në bazë të metodave të strukturuar”, deklaroi eksperti Shala.

Megjithatë, ky ekspert tha se në rastin e

Ferki Ibrahimit ka qenë i domosdoshme trajtimi me barna antipsikotike, me qëllim të zbehjes së orientimit të pacientit.

“Këto barna nuk e japin efektin e varësisë dhe tolerancës të pacientit”, sqaroi para trupit gjykues eksperti Arbër Shala. Sidoqoftë, jo të gjithë janë ndarë të kënaqur me raportin e Klinikës Psikiatrike. Avokati i palës së dëmtuar Bajram Tmava, duke iu referuar raportit të ekspertëve, ka thënë se, në bazë të tij, shihet se mendimi i ekspertëve është i bazuar në tri elemente. Bindja e parë fetare, paranoja dhe xhelozia. Por, atij iu përgjigj eksperti Shala.

“Xhelozia nuk është pasojë e bindjes fetare. Ky ekzaminim nuk është ekzaminim me bindje fetare. Xhelozia është njëra prej varianteve të paranojës. Xhelozia patologjike trajtohet si sëmundje e përhershme, nuk është e përkohshme”, tha eksperti Shala. Po ashtu avokati Tmava ka pyetur ekspertët në lidhje me paraqitjen e xhelozisë. “Xhelozia s’paraqitet prej lindjes as në literaturën botërore, xhelozia patologjike është prej moshës 30 vjeçare e tutje”, ka sqaruar eksperti në fjalë.

Tmava në cilësinë e përfaqësuesit të palës së dëmtuar, ka pyetur po ashtu nëse xhelozia tek i akuzuari Ferki Ibrahim ishte shfaqur para apo pas divorcit.

“Unë mendoj se sëmundja e xhelozisë patologjike të Ibrahimit ka filluar para divorcit me të ndjerën Igballe”, tha para trupit gjykues eksperti Arbër Shala.

Pas dëshmisë së ekspertëve, prokurori Gëzim Lllolluni ka paraqitur vërejtje duke thënë se ka mospërputhje mes konstatimit të eksperteve të dhënë më herët dhe dëshmisë së tyre. Duke i parë këto rrethana, prokurori Lllolluni ka propozuar që në seancën e ardhshme të bëhet një super-ekspertizë për rastin e Ferki Ibrahimit.

Kësaj kërkesë i është bashkangjitur edhe avokati i palës së dëmtuar Bajram Tmava.

Mirëpo, këtë propozim e ka kundërshtuar në mënyrë kategorike avokati mbrojtës Ramiz Krasniqi, pasi, siç ka thënë ai, ekspertët e kanë bërë punën e tyre në mënyrë profesionale.

Propozimi i prokurorit dhe avokatit për super-ekspertizë u hodh poshtë nga trupi gjykues. Seanca tjetër do të mbahet më 13 shtator.

ESHKATERI

Politika e ka shkatërruar Qendrën Klinike Universitare. Kështu thonë shumica e ish drejtorëve të kësaj qendre. Ata japin sugjerimet se si do të mund të ndryshohej gjendja, veprime që vetë nuk kanë mundur t'i bëjnë kurrë.

Nebih Maxhuni

nebih.maxhuni@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 24 –

Lufta mes partive politike, që njeriu i tyre të vendoset në krye të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, tashmë nuk është diçka e re.

Ka 11 vjet që drejtorët e QKU-së kanë qenë njerëz të përzgjedhur nga partitë politike ose thënë më shkurt, njerëz të qeverive që janë në pushtet.

Si pasojë e kësaj, qendra më e madhe spitalore në vend kurrë nuk ka mundur të ofrojë ndonjë shërbim shëndetësor të mirëfillt për pacientët kosovarë.

Aty ka mungesë nga ilaçet e deri të penjtë, që janë material shpenzues i cili ndoshta kushton më së liri.

Shumica prej ish drejtorëve të QKU-së, që për një kohë të gjatë kanë qenë në krye të spitalit më të madh publik në vend, thonë se derisa politika të përzihet në këtë qendër, shpresat janë minimale që ky vend të këndellet.

Jusuf Ulaj, ish drejtor i QKUK-së, thotë se prej pasluftës, Ministria e Shën-



detësisë, varësisht se cili subjekt politik, me parapolitikën përcjellëse e ka konsideruar si resor të vetin QKU-në, aty e kanë sjellë në krye njeriun e tyre.

Sipas tij, edhe kur kjo ka ndodhur, në shumicën e rasteve njerëzit e politikës dhe drejtorët e QKU-së nuk kanë arritur të kenë koordinim dhe bashkëveprim për shkak të përzjerjes në kompetenca dhe interesave personale apo grupe të një rrethi të ngushtë njerëzish.

“Përzgjedhja me interesante ishte ky i fundit i Ali Sadriut, i cili me marifetleqët e veta dhe ndjenjën se ‘ka ardhur nga lart’ shkaktoi kaos të vërtetë në QKU”, thotë Jusuf Ulaj për Express.

Sipas tij, edhe ministri e edhe sekretari i përhershëm (në vazhdimësi “ushtrues detyre”) vijnë nga i njëjti subjekt politik dhe kështu politika përzihet në çdo gjë.

“Shembuj eklatantë të dështimeve për shkak të përzjerjes së politikës dhe MSH-së në investime kapitale në QKUK janë projekti i onkologjisë i filluar qysh në vitin 2004, kardiokirurgjisë dhe furnizimit me medikamente që asnjëherë nuk ka qenë në nivelin e dëshirueshëm”, thotë Ulaj.

Ai vlerëson se derisa nuk largohet ndikimi i partive politike me misionarët e shumtë që defilojnë në QKU, është shumë e vështirë që aty të bëhet ndonjë ndryshim pozitiv në ofrimin e shërbimeve mjekësore për pacientë.

“Qeveria e Kosovës duhet që QKUK-në ta vë në prioritet të vetin, të përzgjidhet një ekip profesional mjekësor së bashku me ekonomistë dhe juristë të përgatitur dhe t’u lihen duart e lira që konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi

Forcohet FSK-ja

Ferizaj 24 qershor- Forca e Mbrojtjes e Kosovës (FSK) po rritet dhe po forcohet për çdo ditë, duke iu përshtatur edhe standardeve të NATO-s. Këto vlerësime i bëri sot në Ferizaj, ministri i FSK-së, Fehmi Mujota, gjatë një vizite në Qen-

drën e Komandës, Doktrinës dhe Stërvitjes në kazermën e FSK-së. Mujota, së bashku me ministrin e Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, komandantin e FSK-së, gjeneraljejtënant Sylejman Selimi dhe nga një grup deputetësh

të Parlamentit të Kosovës, kanë vëzhguar nga afër ushtrimin fushor "Luani i shkathtë 2", të organizuar në kazermën e FSK-së në Ferizaj. I pyetur për angazhimin e komuniteteve dhe të gjinisë femërore

në FSK, ministri Mujota ka thënë: "Edhe këtu kemi përfaqësues të komuniteteve", duke shikuar nga parlamenti Branislav Gërbiq. Ministri Mujota është shprehur i kënaqur me rritjen e përqindjes të pranisë së komuniteteve në

FSK. "Kemi një prani gjithnjë e më të madhe. Tash kemi arritur që 8.8 për qind të pjesëtarëve të FSK-së të jenë nga komunitetet", ka thënë Mujota. Kurse, prania e gjinisë femërore në FSK është në shkallën prej 4 për qind.

ROI POLITIKA



» Jusuf Ulaj

Shembuj eklatantë të dështimeve për shkak të përzjerjes së politikës dhe MSH-së në investime kapitale në QKUK janë projekti i onkologjisë i filluar qysh në vitin 2004, i kardiokirurgjisë dhe i furnizimit me medikamente që asnjëherë nuk ka qenë në nivelin e dëshirueshëm.



» Fadil Beka

Se QKU është në këtë gjendje, fajtor është vetëm faktori njeri. Duhet të ketë një vullnet më të madh për këtë institucion shëndetësor e arsimor, të punohet për të mirën e QKU e jo për një grup të interesave apo interesa personale



» Sali Ahmeti

QKU duhet të ketë autonomi financiare dhe funksionale. Në kuadër të reformimit të sistemit shëndetësor, QKU ja duhet të lirohet nga puna e niveleve dytësore dhe t'i krijohet mundësia të kryejë punën për të cilën është e dedikuar.

E për Sali Ahmetin, një ish drejtor tjetër i QKU-së, reformimi i sistemit shëndetësor do të ndikonte edhe në punën e QKU-së.

"QKU duhet të ketë autonomi financiare dhe funksionale. Në kuadër të reformimit të sistemit shëndetësor, QKU ja duhet të lirohet nga puna e niveleve dytësore dhe t'i krijohet mundësia të kryejë punën për të cilën është e dedikuar", ka thënë Ahmeti.

ta udhëheqin QKUK-në", thotë ai.

Madje, ai ka dhënë edhe një ide se si mund të funksionojë QKU ja normalisht, ku shërbimet do të jenë në nivelin e duhur dhe nuk do të ketë mungesë barnash e të tjera.

"Decentralizimi i QKUK-së nga MSH-ja është hapi i parë i domosdoshëm, pra përgjegjësit për investime kapitale, furnizimin me medikamente e tjera t'i referohen menaxhmentit të QKUK dhe të kërkohet llogaridhënie", thotë ai.

Sipas këtij ish drejtori, në QKU punojnë rreth 550 specialistë të lëmive të ndryshme, në mesin e të cilëve ka profesionistë që janë dhe mund të bëjnë ndryshime për të mirën e QKU-së, në rast se ndonjëri prej tyre të zgjidhet në pozitën e drejtorit ekzekutiv.

Derisa Ulaj mendon se politika ka shkatërruar QKU-në, ish drejtori tjetër Fadil Beka thotë se këtij institucion shëndetësor i duhet një status i veçantë.

Beka thotë për Express se QKU-ja duhet të jetë njëra ndër prioritetet kryesore të qeverisë, duke

propozuar që ajo të jetë agjenci e pavarur e mbikëqyrrur direkt nga qeveria ose kryeministri.

"Deri tash është parë që qeveritë nuk kanë qenë të interesuara të rregullojnë QKU-në. Prandaj duhet të jetë institucion i varur direkt nga kryeministri, mandej gjërat tjera si barnat, shërbimet e të tjera mund të rregullohen përmes mekanizmave të ndryshëm", thotë ai.

Sipas Bekës, drejtorët që zgjidhen për të udhëhequr QKU-në duhet të jenë profesionistë shëndetësorë, njerëz të ndershëm, që kanë përvoja menaxheriale në situata të ndryshme edhe që punojnë në interes të QKU-së e jo për interesa personale apo grupore.

"Se QKU është në këtë gjendje, fajtorë janë vetëm njerëzit. Duhet të ketë një vullnet më të madh për këtë institucion shëndetësor e arsimor të punohet për të mirën e QKU-së e jo për një grup të interesave apo interesa personale", vlerëson ish drejtori Beka.

Të zbardhet fati i të zhdukurve

Bruksel 24 qershor- Një delegacion i Ministrisë së Drejtësisë i kryesuar nga ministri Haki Demolli, po qëndron për vizitë pune në Bruksel (Belgjikë), ku është pritur nga znj. Viviane Reding, zëvendës-presidente e Komisionit Evropian për Drejtësi, të Drejta Fundamentale dhe Shtetësi.

Në këtë takim u diskutua për procesin e integritimit evropian në përgjithësi, me fokus në reformimin e sistemit të drejtësisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë. Ministri Demolli riafirmoi përkushtimin e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Kosovës për të avancuar veprimet në agjendën evropiane.

Ai theksoi se dikasteri që drejton që nga fillimi ka analizuar të gjeturat dhe rekomandimet e Raportit të Progresit dhe ka punuar me përkushtim në përmbushjen e tyre. Gjithashtu, Demolli kërkoi nga zëvendës-presidentja e Komisionit Evropian fillimin e bashkëpunimit me EUROJUST in, organ ky i BE-së, i cili paraqet një rrjet të përhershëm të autoriteteve gjyqësore të ngarkuar me fuqizimin e efektivitetit të hetimeve dhe ndjekjes penale të krimit të rëndë jashtë kufitar

dhe krimit të organizuar në shtetet anëtare të BE-së.

Në fund, Ministri Demolli i propozoi zëvendës-presidentes Reding, që të kërkojë nga Serbia të mos paraqitet si pengesë në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë, si dhe të ofrojë informata dhe të bashkëpunojë lidhur me këtë çështje. Ndërkaq, zëvendës-presidentja Reding duke çmuar lart të arriturat e fundit në Ministrinë e Drejtësisë, shprehu gatishmërinë e saj që Komisioni Evropian të vazhdojë t'i ofrojë mbështetje dhe bashkëpunim Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës.

Gjatë kësaj vizite delegacioni i Ministrisë së Drejtësisë ka realizuar takime edhe me znj. Tanja Fajon, deputete e Parlamentit Evropian, si dhe anëtare e Komisionit për të Drejtat, Liritë Civile, Drejtësi dhe Punë të Brendshme, me Pjer Mirel, drejtor për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerim në Komisionin Evropian, me Lorens Meredith, shefi i Divizionit të Komisionit Evropian për Kosovën, si dhe me znj. Ulrike Lunaček, deputete dhe raportuese për Kosovën në Parlamentin Evropian.

Flasin për shkollë moderne

Prishtinë 24 qershor- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Organizata Joqeveritare Italiane CESES, organizuan konferencë përmbyllëse të projektit: "Për një shkollë moderne dhe gjithëpërfshirëse: Krijimi dhe nisja e Institutit Pedagogjik të Kosovës". Ministri i arsimit Enver Hoxhaj, ka falënderuar Qeverinë Italiane, Ambasadorin Gifoni dhe Presidentin e CESES-it, z. Pollianni për kontributin e çmuar që kanë dhënë në themelimin e IPK-së dhe modernizimin e arsimit në Kosovë. "Pa mbështetjen tuaj dhe të partnerëve tjerë ndërkombëtarë, nuk do të kishim suksesin dhe rezultatet e dëshirueshme", ka thënë Hoxhaj. Hoxhaj ka shtuar se MASHT mbetet e përkushtuar

për gjithëpërfshirje në arsim. Në kemi bërë zgjerimin e hapësirës shkollë, janë siguruar tekste falas për arsimin fillorë, jemi përkujdesur për arsimin të komuniteteve, dhe të nxënësve me nevoja të veanta. Angazhohemi që të kemi shkollë të shëndetshme dhe të sigurt. Tashmë është hartuar Korniza e Kurrikulumit të ri i cili ofron mundësitë që shkollën memorizuese të shekullit 20 ta shëndërojë në shkollë analitike të shekullit 21, ka thënë Hoxhaj. Ambasadori Italian në Kosovë Michael Gifoni ndër tjera tha se Instituti Pedagogjik i Kosovës do të jetë në funksion të modernizimit të arsimit në Kosovë. Ata që ndoqën kurset në Itali, do të jenë të aftë të zbatojnë në praktikë njohuritë fituara.

Ekonomi

TEL: 038 76 76 76 FAX: 038 76 76 78

Telashe me deficitet

Washington, 24 qershor
Liderët botërorë, të cilët u përballën me krizën e rëndë ekonomike të vitit të kaluar me një forcë të paparë, po kanë vështirësi të ruajnë solidaritetin e tyre përballë sfidave të reja. Pavarësisht apeleve nga SHBA-ja që të përmbahen

nga heqja e masave stimuluese aq shpejt, vendet njëri pas tjetrit po nxitojnë të shkurtojnë shpenzimet dhe të rrisin taksat për të shmangur fatin e Greqisë, e cila muajin e kaluar ishte në prag të falimentimit. Përveç kësaj, liderët do të përballen me diferencat

lidhur me rregullimin e sistemit financiar, për t'u siguruar se kriza financiare e vitit 2008 nuk do të përsëritet më. Shumë nga këto çështje nuk priten të zgjidhen. Samiti i vendeve të G20 do të mbahet gjatë vikendit në Kanada.



FOTO: PETRIT RRAHMANI

Pa Dell Ekonomik

Ambasadori Amerikan Christopher Dell ka kritikuar qasjen e institucioneve kosovare në zhvillimin ekonomik. Ai tha se në këtë vend është rrezik për të bërë biznes dhe Qeveria nuk mund të mburret me aftësinë e saj për t'i joshur investitorët e huaj. Dell kërkoi guxim nga Qeveria që t'i shtyjë reformat.

Agon Sinanaj

PRISHTINË, 24 QERSHOR — Qeveria e Kosovës nuk mund të mburret me aftësinë e saj për t'i joshur investitorët huaj. Nuk janë të mjaftueshme as veprimet e saj për uljen e tatimit në të ardhurat e korporatave dhe fitim. Së paku, jo në sytë e ambasadorit amerikan në Kosovë, Christopher Dell.

Ambasadori Dell, dëshmoi edhe njëherë se ka nuhatje në ekonomi.

Ai theksoi se rreziqet e bërjes së biznesit në Kosovë janë të larta, si dhe pengesat burokratike dhe afariste për të investuar në shtetin me të ri nuk janë shkurajuese. Për t'i thënë këto fjalë, ambasadori amerikan shfrytëzoi një takim afarist ku merrnin pjesë edhe ministra të Qeverisë së Kosovës.

“Do të duhet guxim për qeverinë që t'i shtyjë reformat e nevojshme dhe të qëndrojë këmbëngulës derisa reformat të vihen në vend”, tha Dell me rastin e publikimit të studimit

“Rreziqet e bërjes së biznesit në Kosovë janë të larta”

Christopher Dell

“Diagnozë e mjedisit afarist për reformat ligjore institucionale, për agrobiznes dhe mjedis afarist dhe rekomandimet për Kosovën” nga Agjensioni i SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Sipas tij, është vetëm një mënyrë për ta bërë këtë – me ekonomi të lirë, të udhëhequr nga sektori konkurrent privat që krijon vende pune dhe mirëqenie për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Nga ana tjetër, ministri i Ekonomisë dhe Financave, Ahmet Shala, ka thënë se qeveria së bashku me miqtë ndërkombëtarë ka arrit që legjislacioni i Kosovës të jetë i harmonizuar me atë modern dhe që i përshatatet të ardhmes së Kosovës.

“Këto dy projekte kanë identifikuar se Kosova mund të ketë një zhvillim dhe investim në

bujqësi me një qarkullim mbi 750 milionë euro dhe një punësim deri në 200 mijë veta. Kjo nuk do të arrihet për një ditë as për dy e as për tre vjet, sigurisht nevojitet një afat më i gjatë

për të mund të arrihet në këtë shkallë të zhvillimit, sidomos të sektorit të bujqësisë”, tha ai.

E ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe i Zhvillimit Rural, Blerand Stavileci ka thënë se qeveria që nga viti 2008 ka rritur në mënyrë progresive buxhetin për bujqësinë, konkretisht për kategorinë e projekteve të investimeve kapitale dhe për kategorinë e projekteve zhvillimore të granteve e të pagesave direkte.

“Për arsye të forcimit të ekonomisë agro-rurale, në aspektin e kuadrit ligjor dhe të atij institucional, Ministria e Bujqësisë ka ndërmarr vendime dhe hapa konkret në përmirësimin e strukturave të fermave bujqësore”, ka thënë Stavileci.

Studimi agrikulturore është bërë për të vlerësuar mjedisin afarist dhe shoqërohet nga Strategjia për Mundësitë Agrikulturore, e cila përdor modelin sasior për të përcaktuar kombinimin më të mirë të të lashtave për Kosovën, ashtu që të rriten të ardhurat agrikulturore. Kjo metodë po ashtu përshkruan llojet e investimeve që duhet të bëhen për të shfrytëzuar përparësitë që ka Kosova.

TANA

Pavarësisht rritjes ekonomike, Kosova vjet është përballur me rënie të investimeve të huaja, tkurrje të kredidhënies, rritje të kredive të këqija, rënie të remitencave e rritje marramendëse të papunësisë. Express sjell raportin e Bankës Qendrore të Kosovës për vitin 2009, i cili flet për një vit të rëndë ekonomik.

Zekirja Shabani

zekirja.shabani@gazetaexpress.com

PRISHTINË, 24 QERSHOR — Një vit më parë, Qeveria e Kosovës u krenua se pati rritje ekonomike rreth 4 për qind, kur të gjitha vendet e rajonit gati sa kishin hyrë në recession. Kjo edhe është e arritura më e madhe e Kosovës për vitin 2009. Por, vjet shteti më i ri në botë u përball me rënie të investimeve të huaja, tkurrje të kredidhënies, rënie të remitencave e rritje marramendëse të papunësisë. Në raportin vjetor të Bankës Qendrore, që e ka siguruar Express, thuhet se për shkak të shtrëngimit të kredidhënies së bankave komerciale dhe për shkak të rënies së remitencave, konsumi privat ka shënuar rënie për 5.5 për qind. E tërë kjo për shkak të performancës së dobët të sektorit real.

“Investimet e sektorit privat u ndikuan negativisht edhe nga rënia e investimeve të huaja direkte për rreth 20 për qind krahasuar me vitin paraprak”, thuhet në raport.

Gjatë vitit të kaluar sektori bankar kishte kujdes të shtuar të kredidhënies me qëllim të evitimit të efekteve të mundshme negative në



FOTO: JETIMIR IDRIZI

cilësinë e portofolit kreditor.

Niveli i kredive të reja vërehet të jetë më i ulët se viti paraprak. Gjatë vitit të kaluar vlera e kredive të reja ishte 52.5 milionë euro, ndërsa në vitin 2008 ishte 57.8 milionë euro.

Trendi i rritjes së kredive në përgjithësi në sektorin bankar gjatë vitit 2009 ishte me një normë dukshëm më të ulët krahasuar me periudhat e kaluara. Norma vjetore e rritjes së sektorit bankar ishte vetëm 8.9 për qind e ndërkaq në vitin 2008 ishte 32.7 për qind.

“Shtrëngimi i kredidhënies më tepër është vërejtur te kreditë për ndërmarrjet, të cilat në vitin 2009

Takim për rimëkëmbje

Toronto, 24 qershor - Udhëheqësit e 20 ekonomive më të rëndësishme të botës mbledhen në Toronto, më 26 dhe 27 qershor, për të shqyrtuar rrugët për përshtetimin e rimëkëmbjes së ekonomisë globale. Temat më delikate mbi të cilat do të diskutojnë krerët e shteteve dhe zyrtarët më të lartë të financave,

përfshijnë monedhën, tregtinë dhe deficitin buxhetor. Ata do të analizojnë gjithashtu krizën evropiane të borxheve dhe pritet të diskutojnë rreth shtimit të rregullave për firmat financiare, rreth taksave, bankave dhe për çështje të tjera. Udhëheqësit që mbledhen në Toronto drejtojnë vende që sigurojnë 90 për qind të

prodhimit ekonomik, 80 për qind të tregtisë botërore dhe ku jetojnë dy të tretat e popullsisë së botës. Kriza financiare globale bëri të qartë nevojën për rrugë më efektive që të rregullohen firmat financiare, por nuk janë përcaktuar ende mënyrat. Disa ministra financash po u bëjnë thirrje bankave që të pakësojnë

kreditë që japin dhe të mbajnë më shumë kapital në dispozicion në rast se një hua ose investim del pa sukses. Ide të tjera përfshijnë uljen e huas që bankat marrin për të investuar dhe gjetjen e mënyrave për të përballuar problemin e kompanive financiare të dështuara, duke minimizuar

dëmin ndaj pjesës tjetër të ekonomisë. Hoze Vinals i Fondit Monetar Ndërkombëtar pret që në takim udhëheqësit të vendosin nëse do të vënë taksë për bankat në mënyrë që të mbulojnë koston e problemeve të ardhshme financiare. Por ai thotë se ata nuk do të marrin vendime për çështje të tjera.

T'ZEZAT

“Sektori bankar ka përmbyllur vitin me profit neto 29.6 milionë euro, që ishte më i ulët për 30.5 për qind krahasuar me vitin 2008”

Ashtu edhe normat e interesit në kredi janë rritur për 0.3 pikë të përqindjes, ndërsa normat e interesit në depozita kanë rënë për 0.4 %. Dallimi ndërmjet normave të interesit në kredi dhe depozitave në fund të vitit të kaluar ishte 10.1 për qind. “Norma e interesit në depozita ishte 4 për qind, derisa norma e interesit në kredi 14.1 për qind”. Mbi 60 për qind e depozitave në bankat komerciale u takojnë ekonomive familjare, ndërsa ndërmarrjet private kanë 15.3 për qind. Deri në vitin 2009 depozitat e ndërmarrjeve publike përbënin pjesën më të madhe të depozitave në sektorin bankar, me transferin e dividendës së PTK-së të Qeveria e Kosovës, ndërmarrjet publike kanë vetëm 7 për qind depozita në banka.

Në total depozitat arrin 1.74 miliardë euro, shumica e të cilave janë të afatizuara me afat të maturimit deri në një vit, ndërkaq shumica e përgjithshme e kredive është 1.28 miliardë euro.

Sektori bankar ka përmbyllur vitin me profit neto 29.6 milionë euro, që ishte më i ulët për 30.5 për qind krahasuar me vitin 2008. “Zvogëlimi i profitit është rezultat i ngadalësimit të rritjes së të hyrave të bankave komerciale, kryesisht si pasojë e ngadalësimit të aktivitetit kredidhënës”, thuhet në raport.

Përveç kësaj, Banka Qendrore e Kosovës raporton se në Kosovë papunësia ka shkuar mbi 45 për qind. “Numri i punëkërkuarve të regjistruar në Kosovë në fund të vitit 2009 ishte 339 mijë persona. Nga departamenti për punë dhe punësim, si ndërmjetësues, çdo vit punësohen mesatarisht nga 6400 veta”. Paga nominale në sektorin privat në vitin që shkoi ishte 258 euro, ndërsa në sektorin publik 263 euro. Rritja e pagave reale sipas raportit të BQK-së do të ndikojë negativisht në konkurrencën e lirë punëtore. E vjet në Kosovë kanë ardhur vetëm 291.5 milionë euro investime të huaja direkte, që vlerësohet një rënie për 20 për qind krahasuar me vitin paraprak.



Varfërohen evropianët

BRUKSEL, 24 QERSHOR — Një nga gjashtë evropianë kanë vështirësi me pagesat e faturave të rregullta mujore, tregon një anketë e kryer nga Eurobarometri. Anketat tregon se rreth 30 për qind e evropianëve e kanë të vështirë të përballojnë shpenzimet e shërbimeve për shëndetësi, për fëmijët apo për moshën e shtyrë. Një nga gjashtë familje evropiane nuk është në gjendje t'i paguajë shpenzimet themelore, nuk ka para për ushqim apo për nevojat tjera ditore. Komisar i BE-së për çështje sociale, Laslo Andor ka konfirmuar se varfëria është problem i madh në Evropë dhe se kriza ekonomike vetëm e përkeqëson gjendjen.

Hapet Shën Stefani

Podgoricë, 24 qershor - Pas më shumë se tri vitesh, Shën Stefan (Mal i Zi), njëra nga pushimoret më elite të Detit Adriatik, përfundimisht do të hapet për turistë, transmeton SMedia. Siç lajmëroi kompania “Adriatik propetis”, dhjetë vila të rikonstruara në ishullin Shën Stefan në Mal të Zi do të hapen për vizitorët prej 1 korrikut.

Nga kompania, e cila e bleu ishullin, vilat tjera në ishullin e peshkimit do të hapen në mënyrë succesive, një nga një.

“Shtrëngimi i kredidhënies më tepër është vërejtur te kreditë për ndërmarrjet të cilat në vitin 2009 shënuan rritje prej vetëm 4.6 për qind, ndërsa në vitin 2008 kishin 30.4 për qind. Kreditë për ekonomitë familjare u ndikuan në masë më të vogël, duke shënuar rritje vjetore në masë 22.3 për qind e në 2008 ishin 40.1 për qind”

shënuan rritje prej vetëm 4.6 për qind, ndërsa në vitin 2008 kishin 30.4 për qind. Kreditë për ekonomitë familjare u ndikuan në masë më të vogël, duke shënuar rritje vjetore në masë 22.3 për qind e në 2008 ishin 40.1 për qind”, thuhet në raport.

Megjithatë, përkundër krizës financiare ndërkombëtare, sektori financiar në Kosovë ka vazhduar të rritet sa i përket aseteve, duke arritur vlerën e përgjithshme të aseteve në 2.8 miliardë euro. Kjo paraqet një rritje vjetore 24.2 për qind.

“Në këtë rritje sektori bankar vazhdon ta mbajë pjesën më të madhe të aseteve me 78.6 për qind, edhe pse me një pjesëmarrje më të ulët se vjet për 7.5 për qind”.

Në anën tjetër, vjet janë rritur dukshëm edhe kreditë e këqija nga 3.3 për qind në 4.3 për qind.

Ballkan Express

REDAKTOR: FATON RAÇI
E-MAIL: FATON.RACI@GAZETAEXPRESS.COM
TEL: 038 76 76 76 FAX: 038 76 76 78

Çështja çame, tension në Parlamentin shqiptar

Deputetet e PDU-së kanë kërkuar nga parlamenti respektimin e historisë dhe vënien në vend të dinjitetit të 300 mijë shqiptarëve të çamërisë. Deputeti Dashamir Tahiri gjatë fjalës së tij në seancë nga kërkuar ndërtimin e një memoriali atje ku prehen eshtrat e popullsisë çame

dhe më shumë përgjegjshmëri nga ana e qeverisë. Pas fjalës së mbajtur nga Shpëtim Idrizi i PDU-së, deputeti Dashamir Tahiri ka akuzuar kreun e PBDNJ-së, Vangjel Dulen për faktin se nuk u ngrit në këmbë kur u mbaj një minutë heshtje në nder të viktimave të

represionit ndaj çamëve. "Po ju drejtohem personalisht zoti Dule, ju jeni një kulish i Zervës". Pas kësaj ka replikuar Dule, duke iu drejtuar kryetares së Kuvendit, që në një rast tjetër për një kërcënim të tillë do të merrshin masa ndaj akuzuesit.

Daul:



Të funksionojë demokracia

Kryeministri Berisha dhe kreu i PPE në Parlamentin Europian, Joseph Daul kanë dalë sot në një konferencë të përbashkët për shtyp. Daul theksoi se vizita e tij në Tiranë është një apel i hapur që demokracia të funksionojë në këtë vend me qëllim integrimin e vendit.

"Jam në Shqipëri që demokracia të funksionojë, që reformat të thellohen. Demokracia nuk është bojkot por punë e përbashkët, duhen bërë reforma në kodin elektorale. Shqipëria ka nevojë për një demokraci që funksionon, dhe një qeveri e opozitë që funksionon. Opozita duhet të ketë vendin e saj në parlament", - theksoi europarlamentari Daul.

Ndërsa kryeministri Berisha u ndal të theksojë se nga ana e qeverisë së tij cdo gjë funksionin. Sipas kryeministrit opozitës do të plotësohet cdo kërkesë.

"Qeveria ime është e vendosur të plotësojë pikë për pikë të gjitha rekomandimet. Mbetem i vendosur të respektoj cdo vendim të opozitës shqiptare, cdo të drejtë të saj. Shpreh kënaqësi që opozita është sot në parlament", - theksoi Berisha.

Në lidhje me zgjedhjet e ardhshme lokale Berisha u

shpreh i hapur të pranojë cdo amendament të tyre për "ligjet të cilat duhet ti kalojmë së bashku me opozitën. Kemi vullnet të punojmë së bashku. Për zgjedhjet e ardhshme qeveria do pranojë cdo amendament të opozitës, pasi e konsideron të nevojshme që të marrë pjesë në zgjedhje", - theksoi kryeministri

I pyetur përse dështuan negociatat për zgjidhjen e krizës politike shqiptare Daul vuri theksin tek arritjet që ato sollën, ndërsa shton se qeveria ka bërë lëvizjet e duhura për zgjidhjen e saj.

"Vendosëm dy gjëra, njohjen e qeverisë, respektimin e kushtetutës dhe që opozita të punojë në gjirin e parlamentit. Donim të shkonim më lart. Mendoj që kryeministri i dha mundësi funksionimit të shtetit të së drejtës dhe ai funksionin nga ana e qeverisë", - u shpreh Daul.

LUFTANIJET SHQIPERI, PAN

Mbërritja e pesë luftanijeve turke në Durrës dhe Vlorë ka çuar në reagimin e mediave greke dhe atyre bullgare. Mediat kanë shprehur shqetësimin e tyre për anijet turke në brigjet shqiptare.

Mbërritja e luftanijeve moderne turke në Shqipëri me miratim paraprak të parlamentit ka ngjallur reaksione të ndryshme tek agjencitë fqinje të lajmeve. Këtë vizitë e ka pasqyruar edhe Radio Sofja, dhe ndonëse nuk ka pasur deklarata zyrtare diplomatike, duket se edhe diplomacia e vendeve fqinje është përfshirë nga ethet.

Agjencia Bullgare e Lajmeve BTA duke iu referuar kësaj vizite ka deklaruar se mediat greke kanë thënë se manovrat detare turko-shqiptare shtojnë nevojën e rishikimit të konceptit për sigurinë kombëtare të Greqisë.

Duke i referuar gjithnjë mediave bullgare mësojmë se ato kanë raportuar se kjo flotilje kishte parashikuar që të bënin së bashku me luftanijet izraelite një stërvitje të përbashkët, e cila ka dështuar pas sulmit izraelit mbi karvanin e ndihma në drejtim të Rripit të Gazës më 31 maj.

Mediat bullgare shkruajnë se për këto manovra të planifikuara ishin bërë edhe konsultime përkatëse paraprake mes k.admiralit Taylan dhe Komandës së Përgjithshme Detare Izraelite. Mediat greke kanë deklaruar se mes turqve dhe shqiptarëve



kanë filluar marrëveshje të përbashkëta për ndërtimin e bazave detare dhe ajrore.

Sipas rrjetit SManalysis, në shkri-min e Stavros Markos thuhet se "Ko-

operimi shqiptaro-turk për një bazë detare është kërcënim i ri gjeopolitik". Rrjeti grek akuzon se turqit po ndërtojnë një bazë detare afër Vlorës si dhe bazën ajrore të aviacionit në

Maqedoni, nënoficerët shqiptarë ankohen

Nënoficerë shqiptarë nga rajoni i Shkupit dhe Kumanovës, që kryejnë detyrimet ushtarake në kazermat ushtarake në Shkup janë shprehur të indinjuar pas vendimit për transferimin e tyre në kazermën e Shtipit. Ata janë shprehur të pakënaqur me këtë vendim, duke theksuar se në

rast se mbeten në këtë qytet të Maqedonisë Lindore, ata do të braktisin vendin e punës. "Nuk kemi llogari të mbetemi atje, larg familjes, por edhe nuk mund të përballohet. Deri tani kemi qenë mirë në kazermat në Shkup, mirëpo ky vendim ka ardhur ashtu pa prituri", kanë

theksuar për agjencinë e lajmeve INA, ushtarakët shqiptarë. Ata kanë alarmuar politikanët shqiptarë që të alarmojnë këtë problematike. Mirëpo, nënkryetari i Parlamentit, Rafiz Haliti vlerëson se duhet të respektohen rregullat dhe detyrat e dhëna, dhe kjo sipas tij, vlen edhe për ushtarakët

shqiptarë. "Unë deri tani nuk kam pranuar një ankesë të tillë, por mendoj se qyteti i Shtipit nuk është larg dhe ata duhet të respektojnë detyrimet që kanë. Ne si shqiptarë pavarësisht çfarë pozicione jemi duhet të kryejmë detyrat e dhëna dhe obligimet si në Shkup, Shtip,

Veles apo qytete tjera. Kështu që nuk ka arsye për të braktisur vendin e punës", ka theksuar nënkryetari i Parlamentit, i cili thekson se është i gatshëm për të dëgjuar hapur kërkesat e atyre që shprehin ankesa lidhur me këtë problematikë.

(INA)

TURKE NE IK NE GREQI



e Shqipërisë dhe pas kërkesës së BE-së, Tirana vendosi që të caktojë Italinë si avokaten e saj për të mbrojtur Shqipërinë". Greqia është i vetmi vend i NATO-s që nuk ka hequr Ligjin e Luftës ndaj Shqipërisë.

Vizita e grupit të Task Forces turke në ujërat tona tregon se Turqia po merr përsipër detyra të reja në ujërat strategjike të Mesdheut.

U deklarua se "vizita e anijeve turke bëhet në kuadër të bashkëpunimit dypalësh midis flotës shqiptare dhe asaj turke dhe kjo është një vizitë njohëse nga ana e flotës turke. Janë 5 anije të Flotës Detare Turke që ndodhen në portet shqiptare, 3 nga të cilat ndodhen në portin e Durrësit dhe 2 në portin e Vlorës. Ato janë të tipit fregatë.

Po në këtë mision të ri bashkëpunimi, portet shqiptare pritet të kenë rol parësor në rajonin ballkanik. Për këtë u shpreh edhe kryeadmirali Taylan i cili theksoi në konferencën për shtyp: "Shprehim bindjen e thellë që marrëdhëniet shumë të mira që kemi aktualisht do të shërbejnë për rritjen e bashkëpunimit në të ardhmen.

Jam i sigurt që marrëdhëniet tona do të thellohen më shumë". Ndërkohë, komunikata për shtyp e Ministrisë së Mbrojtjes thekson: "Kryeadmirali Taylan duke e vlerësuar vizitën në ujërat e vendit tonë të anijeve që ai drejton si shembull të mirë bashkëpunimi të dy vendeve të së njëjtës familje, dha mbështetjen e vendit që ai përfaqëson për vazhdimësinë e bashkëpunimit midis dy vendeve dhe ushtrive tona"

KONJAK "SKËNDERBEG" DHE SHQIPONJË 2-KRERËSHE PËR TURQIT

Turqit veçse në Bashkinë e Durrësit janë prituri edhe në prefekturë nga prefekti Genc Alizoti dhe stafi i tij.

Aty u bë një shkëmbim dhuratash simbolike. Ushtrarakut të lartë turk iu dhurua një shqiponjë 2-krerëshe në skulpturë, flamuri kombëtar shqiptar, si dhe një shishe konjak "Skënderbeg", prodhim i biznesit durrsak. Në orët e pasdites u dha edhe një konferencë për shtyp nga flota mike.

Taylan praninë e luftanijeve turke në Adriatik dhe Jon e argumentoi me synimet e përbashkëta për rritjen e sigurisë nëpër dete.

"Turqia është e angazhuar maksimalisht, - tha ai, - për rritjen e mëtejshme të sigurisë në detin Mesdhe dhe në Detin e Zi. Pjesë e kësaj strategjie është edhe vizita në Durrës".

Nga konferenca u mësua se njësi e ardhur në ujërat tona, së bashku me të tjerat ka kryer operacione të vështira në oqeanin indian duke siguruar dy-tre vite më parë rrugët e lundrimit të anijeve tregtare kundër piratëve somalezë.

Vlera e një fregate të tillë si "Kemalreis", "Giresun" apo "Akar" llogaritet në 500-600 milionë dollarë. Ato anije janë të klasit "Barbados" dhe "Yavuz". Në bord kanë armë të sofistikuar si raketa të tipeve "Hellfire 2", "Penguin" dhe silura kundër nëndetësve të llojit "Torpedo".



Përfundon samiti i Vendeve të Evropës Juglindore

"Dënojmë sulmet e fundit të organizatës terroriste PKK ndaj qytetarëve turq", është ky mesazhi që doli nga Samiti i Kryetarëve të Shteteve dhe Qeverive të Vendeve të Evropës Juglindore.

Ky samit u organizua në Stamboll dhe përfundoi me publikimin e komunikatës së Stambollit.

Samitit i vunë vulën sulmet terroriste të përjetuara në Turqi, të cilat u dënuan me një deklaratë me shkrim, ndryshe nga komunikata përfundimtare. Në këtë deklaratë zë vend shprehja: "Dënojmë sulmet e fundit të organizatës terroriste PKK ndaj qytetarëve turq."

Presidenti Abdullah Gyl, në konferencën për shtyp që organizoi pas samitit, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit kundër terrorit dhe shtoi: "Nuk mund të bëhet fjalë për mentalitetin 'Terroristi im është i mirë, ndërsa terroristi yt i keq'."

Ndërsa për sulmin e Izraelit ndaj anijes "Mavi Marmara", në komunikatën përfundimtare zuri vend shprehja "e pritëm me keqardhje". Në këtë samit, ku u nënvizua rëndësia e madhe e grumbullimit rreth një tavoline të liderëve të një rajoni problematik si Ballkani, dhe publikimit të një komunikate që prek të gjitha problemet, një prej temave të rëndësishme të agjendës ishte edhe Kosova.

"Rreth statusit të Kosovës mund të ketë mospërputhje mendimesh, por për ne është tepër me rëndësi që të konfirmohet se tema bën pjesë në rrjetin evropian të bashkëpunimit", deklaruan burimet diplomatike dhe tërhoqën vëmendjen mbi referimet e bëra në temat e paqes, stabilitetit dhe sigurisë. Burimet diplomatike gjithashtu vunë theksin edhe mbi rëndësinë, që ka për rajonin, fakti që, në ceremoninë në plan për t'u organizuar me rastin e përvjetorit të masakrës së Srebrenicës, do të marrin pjesë së bashku Presidenti i Serbisë, Boris Tadiç, ai i Bosnjë-Hercegovinës, Haris Sillajxhiç dhe Kryeministri i Turqisë, Rexhep Tajip Erdoan.

Ndërkohë në kuadër të Samitit të Procesit të Bashkëpunimit të Vendeve të Evropës Juglindore, organizuar në Stamboll, Kreu i Shtetit turk, Abdullah

Gyl shtroi një darkë për nder të kryetarëve të shteteve dhe qeverive të ftuar.

Gyl, në fjalimin e rastit u shpreh se e ardhmja e vendeve të rajonit është në një Evropë të bashkuar dhe vijoi me fjalët: "Ky rajon, në zemër të Evropës, prodhon paqe, stabilitet dhe mirëqenie." Pasi shpjegoi se trashëgimia kulturore e përbashkët e vendeve të Evropës Juglindore lidh të kaluarën me të ardhmen, Presidenti Gyl tërhoqi vëmendjen se kjo lidhje formon shtyllën vertebrale të përpjekjeve në drejtimin të integritetit politik dhe ekonomik. Presidenti Abdullah Gyl deklaroi se muzika është një nga mënyrat, që shpreh më mirë identitetin kulturor dhe shtoi se "Kemi nevojë të këndojmë dhe dëgjojmë këngë miqësie e uniteti".

Kryeministri Erdoan dje dha një gosti për nder të liderëve, që ndodheshin në Stamboll me rastin e Samitit të vendeve të Evropës Juglindore. Erdoan në fjalimin, që mbajti aty, pasi kritikoi mosdhënien e mbështetjes për Turqinë në luftën kundër terrorit, tha: "Disa vende evropiane, pavarësisht dhimbjes së madhe të përjetuar nuk ja ndërpresin të ardhurat financiare organizatës terroriste dhe nuk i ekstradojnë anëtarët e kapur të organizatës terroriste. Kjo punë nuk përfundon thjesht duke shpallur PKK-në si një organizatë terroriste."

Kryeministri Rexhep Tajip Erdoan tha se në temën e luftës kundër organizatës terroriste disa vende evropiane nuk e kishin dhënë mbështetjen e duhur.

Organizata terroriste nuk ndikon vetëm Turqinë, por edhe Evropën, duke thënë se "siguria e Ballkanit fillon nga Hakjar dhe Shemdinli", kryeministri Erdoan bëri thirrje për luftë të përbashkët kundër terrorit.

Kryeministri Erdoan në kuadër të këtij samiti zhvilloi gjithashtu takime dypalëshe edhe me Presidentin e Serbisë, Boris Tadiç dhe me Kryeministrin e Greqisë, Jorgo Papandreu.

Kuçovë.

Por burimet diplomatike greke deklarojnë se "Turqia ende nuk është shteti mik për të garantuar sovranitetin



Paguaj më pak, për të përfituar më shumë!

Zgjedhni pakon tuaj

Tani produktet dhe shërbimet në bankën tonë janë të dizajnuara sipas nevojës dhe kërkesës suaj, që ju të kurseni jo vetëm para, por edhe kohën e çmuar.

PAKO PËR INDIVIDË



PAKO PËR BIZNES



...JETO MË MIRË



**Raiffeisen
BANK**

Raiffeisen Direct: 038 222 222
www.raiffeisen-kosovo.com

Bota

REDAKTOR: ARSIM BUXHOVI
E-MAIL: ARSIM.BUXHOVI@GAZETAEXPRESS.COM
TEL: 038 76 76 76 FAX: 038 76 76 78

Australi, merr detyrën kryeministrja e parë femër



Është ulur sot për herë të parë në historinë e këtij shteti në karrigen e kryeministrit një grua. Ajo bëri sot betimin përpara Guvernatorit të Përgjithshëm, Quentin Bryce. Menjëherë pas ceremonisë, Julian Gilliard tha se ajo e pranoi këtë detyrë sepse beson se qeverisja e mirë e ka humbur rrugën. Më tej ajo tha se vendimi i parë që do të marrë do të jetë ulja shpenzimeve të

qeverisë. Gilliard deri më tani ka mbajtur postin e nënkryetares së Partisë Laboriste në Australi. Megjithatë, sondazhet e fundit në vend tregojnë për një rënie të popullaritetit të Gilliard për shkak të një sërë manovrimesh politike, përfshirë vendimin për t'i prishur planet që ndotësit më të mëdhenj të Australisë të paguajnë për emisionet e gazrave që i lëshojnë.

GRINDJA E RE PER GAZIN

PASOJAT JO AQ TË RËNDA SA NË GRINDJEN ME UKRAINËN

Pasojat e mosmarrëveshjes aktuale për gazin midis Bjellorusisë dhe Ruisë kanë arritur edhe te BE. Komisarari i BE për Energjinë, Oettinger, i bëri thirrje Moskës dhe Minskut që t'i respektojnë marrëveshjet e furnizimit.



Komisari i BE për Energjinë, Günther Oettinger, u kërkoi qeverive ruse dhe bjelloruse që t'u japin fund ndryshimit të mendimeve dhe të kujdesen për një furnizim pa pengesa me gaz të BE. BE nuk duhet të bëhet peng i një mosmarrëveshjeje bilaterale, ishte mesazhi i Oettingerit:

"Ne presim që kjo krizë dhe politika midis Ruisë dhe Bjellorusisë të mos vijnë në Evropë. Dhe nëse Lituania merr tani 40% më pak gaz, atëherë këtu nuk kemi të bëjmë me një problem vetëm për këtë vend anëtar të BE. Ky është një sulm ndaj të gjithë Bashkimit Evropian." Pyetjes se cilat janë mjetet e presionit që ka ai në dorë, Oettingeri u përgjigj indirekt. Ai tërhoqi vëmendjen te interesi ekonomik i të dyja shteteve si partnerë tregtarë të BE.

Edhe një ndalim i plotë i transferimit të gazit megjithatë nuk do të kishte pasojat shumë të rënda. Nga njëra anë, për shkak të verës praktikisht nuk nevojitet gaz për ngrohje. Nga ana tjetër, Bjellorusia është vend transit vetëm për gjashtë për qind të gazit që konsumohet në BE. Krejt ndryshe ishte puna në rastin e Ukrainës në vitin 2009. Atëherë, një luftë çmimesh midis Ruisë dhe Ukrainës bëri që në pjesë të tëra të Lindjes së BE për dy javë të mos shkonte gaz. Njerëzve iu desh të rrinin në banesa akull të ftohta. Me grindjen më të fundit nuk ka të bëjë asnjë vendim për konkurrencën e Komisionit, por ai është pjesë e përpjekjeve të BE për të garantuar sigurinë e furnizimit. Në bazë të këtij vendimi, qeveria polake lejohet që ta mbështesë zjerimin e kapaciteteve të saj të deponimit të gazit me gati 400 milionë euro subvencione shtetërore. Zëdhënësja e Komisionit, Amelia Torres e sqaroi vendimin: "Kjo është shumë e rëndësishme për sigurinë e furnizimit me energji, jo vetëm në Poloni, por edhe në vende të tjera. Polonia do t'i avancojë me këtë rezervat e saj të gazit në mesataren e BE, pikërisht 14% të konsumit vjetor." Edhe nëse kjo grindje e re për gazin nuk do të ketë pasojat negative të rënda për BE, ajo do t'i forcojë përpjekjet për t'u bërë më të pavarur nga Rusia si vend furnizues dhe nga vendet transite. Midis të tjerave, projekti i së ashtuquajturës Nabuko-Pipeline nga Azia qendrore në Evropë do të marrë shtysë të re.

Danimarka i cilëson të pabaza kritikën e Rasmussen

Kryeministri danez, Lars Loekke Rasmussen, i cilësoi të pabaza kritikën e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s lidhur me tërheqjen e Danimarkës nga tri projekte të Aleancës Atlantike për arsye buxhetore.

"Kontributi i ushtarëve danezë i ka kaluar të gjitha përmasat e vendit tonë, duke treguar se Danimarka është një partner i besueshëm", nënvizoi kryeministri danez lidhur me deklaratat e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s.

Lars Loekke Rasmussen theksoi se duhet pasur kujdes me fjalën

"josolidarizim" kur bëhet fjalë për mbrojtjen daneze.

"Mendoj se nuk është e drejtë të mbash peshën e të tjerëve", kishte deklaruar sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, në lidhje me tërheqjen e Danimarkës nga tri projekte të Aleancës për arsye të shkurtimeve buxhetore.



98 €
* çmim special *

Kalo pushimin veror me ne
★ Mëso diçka të re!

AUK
Training and Development Institute

SUMMER OPPORTUNITIES.

IT ESSENTIALS I
H M M E P Sh D
fillon më + 28 Qershor

CCNA DISCOVERY I
H M M E P Sh D
fillon më + 6 Korrik

AUK Training and Development Institute paraqet klasët e reja me çmime speciale për sezonin veror 2010.

Na kontaktoni ★ për ta siguruar vendin tuaj në klasën përkatëse.

Numri i kandidatëve për klasë është i limituar.

për më shumë vizitoni: www.aukonline.org/TDI

AUK TDI
038 518 542 ext:148
044 509 801
auki@aukonline.org

CISCO

Sukcesat juaj. Pasioni ynë.

AUK TRAINING AND DEVELOPMENT INSTITUTE

Konsumator i nderuar,

i ke të gjitha të drejtat për furnizim me energji elektrike. Vetëm ndjekni procedurat dhe kryej obligimet.

Për më tepër thirr në: 038 55 11 00 ose kliko në: www.kek-energy.com

KEK
KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS SH.A
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA
ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS



**Merrni kuponin fiskal
bëhuni faktor i forcimit të shtetit**



**Me arkat fiskale sigurohesh se tatimi i
paguar shkon në buxhetin e Kosovës**



Çerdhja e fëmijëve "BABY LAND"
Si në shtëpinë tënde!

All Inclusive!

Ne kujdesemi për te gjitha , ju vetëm e sillni foshnjën e juaj deri ne çerdhe. Ushqim i begatshëm sipas menysë se pasur bazuar ne literaturën me bashkëkohore.

Doni te jeni rehat ne pune ? Fëmija i juaj do te jete nen kujdesin e edukatoreve tona dhe stafit te Baby Land.

Shërbime shtese:

Përmes kamerave nga shtëpia apo zyra e juaj, e mbikëqyrni bashke me ne punën dhe kujdesin e stafit tone.

Kujdesi pas orarit te rregullt:

Doni te kaloni një mbrëmje te këndshme me shoqëri, pa brenga se fëmija juaj nuk është rehat?

Ne kujdesemi për foshnjën e juaj, deri ne orën 24:00.

Sipas interesimit, oferte e veçante për ndërrime te natës dhe ditën e diel.

Vendi:

Ambient i pastër dhe këndshëm për fëmijën tuaj. Ajri i Gërmisë dhe kujdesi i shtëpisë prej edukatoreve te përgatitura dhe te përkushtuara.

Na kontaktoni:

Emaili: babyland.pr@gmail.com

Telefoni mobil:

045 297 997

049 888 616

Gjendemi përballë Teatrit "Dodona"



**ORARI DITOR I FLUTURIMEVE
DAILY FLIGHT SCHEDULE
E PREMTE 25 QERSHOR 2010
FRIDAY, 25 JUNE 2010**

ARRITJA ARRIVAL	NGA FROM	PËR TO	NISJA DEPARTURE	OPERATORI OPERATOR
/	PRISHTINA	LJUBLJANA	05:00	ADRIA AIRWAYS
/	PRISHTINA	ISTANBUL	05:25	TURKISH AIRLINES
05:30	ANTALYA	ANTALYA	06:30	COREDON AIRLINES
/	PRISHTINA	PODGORICA	06:45	MONTENEGRO AIRLINES
/	PRISHTINA	VIENNA	07:25	AUSTRIAN AIRLINES
/	PRISHTINA	TIRANA	07:30	BELLEAIR
08:30	ZURICH	ZURICH	09:50	BELAIR
08:45	ZURICH	ZURICH	09:35	EDELWEISS
12:50	VIENNA	VIENNA	14:20	AUSTRIAN
13:40	ISTANBUL	ISTANBUL	14:35	TURKISH AIRLINES
14:25	BUDAPEST	BUDAPEST	15:05	MALEV
15:00	LJUBLJANA	LJUBLJANA	15:45	ADRIA AIRWAYS
16:15	LONDON	LONDON	17:00	BRITISH AIRWAYS
18:50	ZURICH	ZURICH	19:35	EDELWEISS
19:30	TIRANA	/	/	BELLEAIR
20:30	PODGORICA	/	/	MONTENEGRO AIRLINES
20:45	MUNCHEN	/	/	XL AIRWAYS
23:35	ZAGREB	/	/	CROATIA AIRLINES
00:40	ZURICH	ZURICH	04:15	EDELWEISS
01:20	LJUBLJANA	/	/	ADRIA AIRWAYS

Gjenerali Petraeus zëvendësohet me McChrystalin

Presidenti amerikan, Barack Obama, ka vendosur pas një takimi kokë më kokë që të lirojë nga detyra komandantin e trupave të NATO-s në Afganistan, Gjeneralin Stanley McChrystal.

Presidenti Obama shpreson se zëvendësimi i komandantit do

të bëhet shumë shpejt. «Unë kam pranuar sot dorëheqjen e gjeneralit Stanley McChrystal nga posti i komandantit të forcave ndërkombëtare në Afganistan. Njëherazi jam i lumtur të emëroj Gjeneralin David Petraeus për të marrë udhëheqjen e forcave

tona në Afganistan, ku duhet të shënojme sukses», theksoi Obama. Sipas tij, Gjenerali David Petraeus është i gatshëm që këtë post ta marrë brenda disa ditësh. Zgjedhja e Petraeusit duhet të konfirmohet edhe prej Kongresit. Gjenerali McChrystal është

liruar nga kjo detyrë, pas një artikulli në një revistë muzikore, ku është shprehur me fjalë përcmuese për disa anëtarë të kabinetit qeveritar dhe diplomatë amerikanë, si dhe për vetë presidentin Obama.

Petraeus është aktualisht ko-

mandant i Komandës Qendrore Amerikane në Lindjen e Afërme e kohë pas kohe ka udhëhequr edhe njësitë amerikane në Irak. Deri në konfirmimin e zgjedhjes së tij, trupat ndërkombëtare në Afganistan do të udhëhiqen nga gjenerali britanik Nick Parker.


DISIDENTI I DIKURSHE

Fillimin e tatëpjetës së komunizmit në Evropë e shënoi themelimi i Solidarnoshqit në Poloni, sindikatës së parë e pavarur në bllokun lindor.

Zhvillimet e vitit 1989 në Poloni paraqesin fillimin e një ere të re në Evropë. Zgjedhjet e para të lira në qershor të këtij viti, fitorja e befasishme e opozitës dhe emërimi i Tadeush Mazowieckit si kryeministër i parë jo komunist në këtë vend, sinjalizuan fillimin e ndryshimeve të mëdha të sistemit komunist në Evropën Lindore, para rënies së murit të Berlinit. Por, rruga e Polonisë në demokraci kishte filluar dhjetë vjet më parë në Dancing, ku filluan ndryshimet e udhëhequra nga sindikatat Solidarnashq dhe Leh Valensa.

Fillimin e tatëpjetës së komunizmit në Evropë e shënoi themelimi i Solidarnoshqit, sindikatës së parë të pavarur në bllokun lindor. Lech Walesa, udhëheqësi i kësaj sindikate dhe grevave më të mëdha në historinë e bllokut lindor, më vonë President i Polonisë, hedh një vështrim pas.

“Në vitin 1980 ia dolëm t’i bashkojmë të gjitha grupet sociale në Poloni, madje me mbështetje dhe solidaritet edhe nga bota e jashtme. Komunistëve mund t’u thoshim: kenë gënjyer gjithmonë, sepse ne jemi shumicë dhe ne nuk ju duam më! Pas kësaj goditjeje, ata më nuk mund të vepronin. Ishte kjo fitorja e parë e masave kundër komunizmit. Ata më nuk mund të bashkohehin dhe të vepronin me sukses si në të kaluarën. Fitorja e dytë e madhe në atë kohë ishte lëvizja e parë e pavarur partiake në bllokun lindor. Ishte kjo një fitore 2:0 për ne



Lech Wałęsa dhe rreth 80 për qind e polakëve janë të bindur se udhëtimi i parë i pelegrinazhit të Papa Gjon Palit të Dytë në vitin 1979 ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në themelimin e

Solidarnoshqit dhe rrëzimit të sistemit komunist.

“Ati i shenjtë ishte mbështetja jonë, ai na ka dhuruar shpresa të reja dhe vlera për themelimin e Solidarnoshqit. Kjo na dhuroi

fitore të tjera.”

As vendosja e gjendjes së luftës në Poloni më 13 dhjetor 1981 dhe internimi njëvjeçar i Lech Wałęsës nuk e shpëtuan komunizmin. Presidenti polak, Lech Valensa,

gjunjëzohet para Papës Gjon Pali II, 22 Maj 1995.

„Gjatë arrestimit u kam thënë se ne jemi fitues. Për ju komunistët kjo është gozhdë e fundit në arkivol. Kam qenë i sigurt se

Tragjedi në Spanjë, treni shtyp 12 persona



12 persona kane humbur jetën dhe 17 te tjerë janë plagosur natën e kaluar ne Barcelone. Te rinjtë kanë kaluar mbi binarë në vend që të kalojnë nënkalimin dhe janë shtypur nga një tren i shpejtësisë së lartë. Ekipet e shpëtimit kane mbërritur menjëherë ne vendngjarje duke i

dhënë ndihmën e shpejte te plagosurve. Televizioni shtetëror TVE njoftoi se me qindra persona kalonjë përmes dhe jo ne nënkalimin midis Barcelonës dhe Alicante. Trupat e viktimave u gjeten me gjymtyre te ndare ne vendin e ngjarjes ne aksidentin ne stacionin e plazhit

e Castelldefels. Radioja vendase informoi se grupi i te rinjve sapo kish zbritur nga treni dhe kane kaluar mbi binare për te arritur ne anën e plazhit. Me qindra te rinj po festonin festivalin ne plazh ne qytetin verilindor te Spanjës. 24 Qershori, Dita e Shën Gjonit,

është një festë publike në shumë pjesë të Spanjës dhe festimet tradicionalisht fillojnë një nate me pare me ndezjen e zjarrit. Aksidenti ishte tragjedia më e keqe hekurudhore e Spanjës që prej vitit 2003 kur dy trena u përplasen dhe humben jetën 19 persona.

EM POLAK

Kjo bindje u forcua dhe me çmimin Nobel për paqe që Lech Wał sa fitoi në vitin 1983. Çmimin e morën gruaja dhe djali i tij në Stokholm, sepse Walesa nuk donte të largohej nga Polonia.

"Kam qenë i sigurt se lëvizja, në krye të së cilës isha unë, dikur do të nderohet me çmimin Nobel për paqe. Kjo ndodhi në vitin 1983, që është mirë, sepse më 1982 do të ishte tepër herët. Në vitin 1983 punët nuk ishin tepër mirë, ndërkohë që çmimi Nobel na dha një fuqi të re për të vazhduar drejt fitores." Valensa me 200 polakë të rinj të lindur më 31 gusht 1980, ditën e krijimit të lëvizjes. Kur qeveria e Jaruzelskit tregoi gatishmëri për lëshime në vitin 1988, Walesa kërkoi ndërprerjen e protestave dhe fillimin e negociatave.

"Unë kam besuar vetëm një gjë dhe për këtë kam luftuar: nuk ka liri pa Solidarnoshqin. Kam dashur që lëvizja sërish të fuqizohet dhe të luftojë për rrëzimin e komunizmit. Natyrisht që kam bërë edhe kompromise, pa të cilat nuk do të shkonte".

Pushtetmbajtësit e kishin kuptuar se nuk mund të bëhet asnjë lëvizje me injorimin e sindikatës Solidarnoashq dhe Wał sës.

"Tryeza e rrumbullakët ishte sipas mendimit tim një mistifikim. Komunistët e kanë ditur se cilat janë dobësitë tona. E kanë ditur se as ata nuk janë të fortë, por ishin më të fortë se ne. Prandaj mendoj se e kanë zgjedhur variantin e sigurt me 35% të vendeve në Parlament. Kishin planifikuar që disa prej nesh t'i kryejnë punët e tyre dhe që komunizmi të mbijetojë. Në anën tjetër mendoja se ne duhet të marrim atë që na ofrohet dhe kështu filloi e gjitha".

Sot, 20 vjet pas rrëzimit të komunizmit, Walesa nuk ka asnjë fije dyshimi se ia ka vlejtur të luftohet, pa marrë parasysh pasojat.

"Ja ka vlejtur. Po të filloja sërish nga e para, do të bëja të njëjtat gjëra. Kam besuar se polakët gjatë jetës sime do të jenë një popull i lirë dhe se do të fitojmë ato që gjenerata më parë kanë ëndërruar, se do të lirohemi nga sovjetët dhe skllavëria. Të gjitha këto u bënë realitet, ndërsa unë kam pasur një rol të rëndësishëm. Mund të jem shumë i lumtur për këto zhvillime dhe fitoren që shënuam."

një lëvizje kaq e fuqishme nuk mund të ndalet. Ishte vetëm çështje kohe. Ne u detyruam t'i përballojnë disa goditje, por asnjë sekondë nuk kam dyshuar në fitoren tonë."



Forum pa rezultat!

Si duhet dhe si mund ta trajtojnë mediet temën e së ardhmes ndryshim i klimës? 1500 pjesëmarrës diskutuan për tri ditë në Global Media Forum të Deutsche Welles. Të mërkurën (23.6) aktiviteti mori fund.

Pas tri ditësh dhe 54 aktiviteteve atmosfera në mbyllje të Deutsche Welle Global Media Forum në Bonn u bë shumë personale. Sekretari i shtetit në Ministrinë Federale për Arsimin dhe Kërkimet, Georg Schütte, citoi të bijën:

"Nganjëherë ke nevojë për fjalët e një fëmije për të qartësuar çështje komplekse me koncepte të thjeshta. Më lejoni të citoj time bijë. Para pak ditësh ajo më tha: "Babi, shuaje dritën, ndryshe do t'i vrasësh arinjtë e akullit."

Drejtori i televizionit të DW, Christoph Lanz, e shfrytëzoi në

fjalën e tij përmblylëse këtë dhe citoi gjithashtu fëmijën e tij: "Çdo mëngjes im bir më thotë në banjë: "babi, mbylle rubinetin, uji na duhet më vonë."

Shqetësimi për të ardhmen ishte temë e Deutsche Global Media Forum, sepse bëhej fjalë për ndryshimin e klimës dhe trajtimin e saj në medie. Për tri ditë shkëmbyen mendime rreth 1500 pjesëmarrësit nga 95 vende, diskutuan me njëri-tjetrin. Si fill i kuq kaloi edhe në tri ditët e Deutsche Welle Global Media Forum edhe kërkesa për një profesionalizim të mëtejshëm të ga-

zetarëve. Christoph Lanz theksoi se gazetarët duhet të raportojnë me cilësi të lartë profesionale për temën komplekse të ndryshimit të klimës:

"Fokusi ynë ishte qartësisht në përmirësimin e raportimit, të cilësisë gazetareske. Tema e ndryshimit të klimës është kaq komplekse, sa ne si gazetarë duhet të vendosim standarde të larta. Ne duhet të jemi të sigurt dhe të besueshëm. Këtu nuk bëhet fjalë që vetëm të transportojmë zërat dhe mendimet e njerëzve të tjerë. Këtu bëhet fjalë që të investigojmë probleme, të kërkojmë zgjidhje dhe t'i përcjellim rezultatet te përdoruesit tanë, të dëgjuesit dhe spektatorët."

Një apel, i cili gjeti mbështetje. Që të martën shkencëtarja amerikane Naomi Oreskes tërhoqi vëmendjen në Bonn për hendekun midis pohimeve të shkencëtarëve dhe paraqitjes në medie. Një pasojë e mungesës së dijeve nga ana e gazetarëve, tha Oreskes. Prandaj kanë ndikim kaq të madh skeptikët e klimës. Por ndryshimi i klimës, sipas saj është një fakt i dëshmuar shkencërisht. Gjithsesi, është një pjesë e madhe e njerëzve që tregohet e preokupuar për ndryshimin e klimës. Këtë e nxori në pah një anketim i kryer para konferencës me 13 mijë vetë në 18 vende të të gjitha kontinenteve. Një rezultat tjetër: njerëzit janë të gatshëm, që ta ndryshojnë sjelljen e tyre; shumë prej tyre janë të gatshëm të paguajnë edhe çmime më të larta për produkte që e ruajnë ambientin.

Deutsche Welle Global Media Forum i ardhshëm është në maj 2011. Tema mbizotëruese do të jetë: "Të drejtat e njeriut në një botë të globalizuar - sfida për mediet."

Soros:

Politika gjermane, rrezik për Evropën

Miliarderi amerikan, George Soros, e cilëson politikën gjermane si rrezik për Evropën dhe për projektin evropian.

Këto komente Soros, i cili njihet si person që ka bërë pasuri duke speculuar me valutat, i bëri në një intervistë për të përjavshmen "Die Zeit" që publikohet të enjten në Gjermani. "Në prirjen e saj të ashpër ndaj rreptësisë buxhetore, Gjermania është izoluar në shkallë botërore. Politika gjermane është një rrezik për Evropën, ajo mund të shkatërrojë projektin evropian", theksoi Soros. Deklaratat e miliarderit amerikan vijnë në një kohë kur Merkel dhe Obama kanë shfaqur mendime të kundërta lidhur me masat që duhen marrë për daljen nga kriza. Gjermania ka njoftuar për zbatimin e një politike të rreptë ekonomike për rimëkëmbjen e financave publike, ndërkohë që Shtetet e Bashkuara bëjnë thirrje për të privilegjuar mbështetjen për rritjen ekonomike. Soros mbështet Presidentin amerikan, Barack Obama, dhe thekson: "Kreditorët e botës, sidomos Gjermania dhe Kina, duhet të ndihmojnë gjithashtu në daljen nga kriza". Por, miliarderi e mbështet Gjermaninë për domosdoshmërinë e rregullimit të tregjeve financiare dhe shprehet në favor të parimit të një takse për transaksionet financiare.



arté

REDAKTOR: ARBEN IDRIZI
e-mail: arben.idrizi@gazetaexpress.com
tel: 038 76 76 76 fax: 038 76 76 78

Hrabal në shqip

Shtëpia botuese "Zenit" sjell në shqip një prej shkrimtarëve më të mëdhenj çekë të gjysmës së dytë të shekullit XX, autorin çek Bohumil Hrabal, me librin "Një vetmi me shumë zhurmë". Hrabal nisi të botonte në vitin 1963, por u censuroa për fjalë banale dhe pornografi, e më pas me "revolucionin të Pragës", iu nda-

lua botimi. Ky liber e bëri të njohur në Francë, kurse "Dasmata në shtëpinë tonë" dhe "Trena të mbikëqyruar reptësisht" e bënë të famshëm në të gjithë botën. "Hrabali është një shkrimtar që fal në jetë dhe kjo për shkak të pasionit dhe sajimit të pafundmë që shpalos njeriu për ta ruajtur dhe pasur jetën: ai është

i shastisur, i verbuar, i joshur prej kësaj egërsie për të jetuar që është në bazën e gjithçkaje... I tronditur thellë në planin metafizik, Hrabali nuk jep gjykime morale mbi jetën: ai është krejt e kundërta e një metafiziceni moralist - pra antipodi i një Ciorani", shkruan në parathënie e esesë "Për Hiçin e Zotit", Vaclav Jamek.

FOTOLAJM



LONDËR, 24 QERSHOR
Piktura e Picasso-s nga "faza blu" është shitur për 34.7 milionë funte, në ankandin Christie në Londër. Nga shitja e pikturës së vitit 1903, "Portreti i Angel Fernandez de Soto", do të përfitojë Andrew Lloyd Webber Foundation, një organizatë bamirëse e cila promovon artin, kulturën dhe trashëgiminë. Portreti u ble nga një ofrues anonim përmes telefonit.

(Foto: AP)

Lexuesi s'kërkon diktaturën, por letërsinë e mirë

Piro Misha i bashkohet debatit të ngritur nga gazeta "Shqip" në lidhje me temat mbi Shqipërinë komuniste, të cilat zënë më së shumti vend dhe preferohen më tepër të përkthehen në gjuhë të huaja prej botuesve apo edhe lexuesit të huaj.

Intervista botohet me një shkurtim.

Z. Misha, në letërsinë shqiptare, një vend kryesor zënë temat që kanë të bëjnë me periudhën e diktaturës në vend. Ndërkaq mendohet edhe se kjo lloj letërsie është edhe ndër të preferuarat prej botuesve të huaj, por edhe më të kërkuarat nga lexuesit e huaj. Mendoni se kemi të bëjmë me një fenomen në zhdrukje apo në rritje?

Nëse flasim në kuadrin e të gjithë Europës postkomuniste, pa dyshim që gjatë këtij 20-vjeçari ka pasur abuzim me këtë term që shpjegohet me interes publik. Ky nuk është një konstatim i imi, është një konstatim i përgjithshëm i një kritike europiane apo botërore. Realisht pati një ngopje me këtë temë, por kjo nuk e përjashton faktin që nëse dikush, një shkrimtar, arrin që ta trajtojë këtë temë në mënyrën e duhur me originalitet, atëherë të jetë i vlerësuar. Ne kemi shembullin e romanit të fundit të Fatos Kongolit, që merret me temën e diktaturës, merret në njëfarë mënyre me temën e kapërcyellit nga diktatura në kohën tonë. Ky roman ka pasur sukses, qoftë në Francë, qoftë në Spanjë etj. Por në konstatimet e përgjithshme duket se ka një ngopje me këtë temë. Kjo vjen për shkak të një abuzimi të disa shkrimtarëve që u përpoqën të përfitonin nga ky moment.

Fakti që kanë të bëjnë me një

fenomen të panjohur e bën më tërheqëse si për lexuesin ashtu edhe për botuesin e huaj këtë lloj letërsie?

Botuesi i huaj, dhe kur themi botuesi i huaj nënkuptojmë lexuesin e huaj, interesohet në radhë të parë për letërsinë e mirë. Letërsia është një çështje individuale, nuk është çështje e një letërsie. Pa dyshim në një moment të caktuar, një letërsi e caktuar ka sukses, ka një traditë dhe tani ne kemi Kadarenë. Ai nuk përkthehet thjesht si shqiptar. Përkthehet si një shkrimtar i mirë që i jep diçka lexuesve që nga Europa deri në Brazil e në Japoni. Po kështu, edhe shkrimtari Fatos Kongoli i cili është i suksesshëm jashtë. Nuk është thjesht tematika e tij, edhe pse padyshim tematika ka rëndësinë e vet, që të ketë një element universal, të japë një mesazh, që kalon kufijtë, të mos jetë thjesht lokale, e vogël, e mbyllur në rrethin e një vendi të caktuar, por tematika ka një vlerë relative. Problemi është që shkrimtari të ketë aftësinë të japë një vepër të mirë, të japë një letërsi të mirë dhe të përçojë atë që është origjinale.

A duhet ta shohim si problematike idenë e përzgjedhjes së këtyre temave dhe dëshirën për t'u përkthyer. Ka vend për problematikë?

Unë nuk e shikoj aspak problematike këtë. Veç këtyre shkrimtarëve që përmenda, është

edhe Orneta Vorpsi, e cila botohet sot me shumë sukses në Francë e në Itali. Pavarësisht se nuk shkruan në gjuhën shqipe, flet për Shqipërinë, e njëjta gjë ndodh edhe me shkrimtaren Anilda Ibrahimimi e kështu me radhë. Flasin për përvojën që ka kaluar ky vend e përvoja e këtij vendi është përvoja jonë kolektive, qoftë edhe individuale, nuk është nga më të lumturat. Për fat të keq, ne e dimë që kemi kaluar një periudhë të keqe, periudhën e komunizmit. Letërsia nuk është një mjet propagande, ajo është një mjet përcimi të një mesazhi njerëzor. Nëse vepra e Kongolit ka një atmosferë të zymtë, e cila zbutet nga ironia që e përshkon atë, kjo nuk e nxin Shqipërinë, përkundrazi. Në qoftë se një vend si Shqipëria arrin të përçojë një letërsi të mirë, i bën vetëm mirë imazhit të vet. Kështu që ky merak se mos kjo tematikë nxin imazhin tonë, mua më duket disi fëmënor, i papranueshëm. Letërsia e mirë është letërsi e mirë dhe temat shpeshherë janë dramatike. Mua më vjen keq që ne kemi shumë pak letërsi të mirë me tematikën e tranzicionit tonë. Kjo periudhë është aq e pasur me tematikë të dhimbshme, por njëkohësisht mjaft interesante nga përvoja njerëzore, por ndoshta duke qenë të zhytur shumë pranë afër nesh, shkrimtarët shqiptarë nuk kanë arritur ende t'i japin siç duhet përvojën e këtij 20-vjeçari që është mjaft interesant.

ZBULOHEM



Zyrtarët e Vatikanit i kanë zbuluar pikturat të martën, të gjetura bashkë me imazhet më të hershme të njohura të apostujve Gjon dhe Andrea në një dhomë nëntokësore të groposur nën një ndërtesë në rrugën të zënë në një lagje mesatare të Romës.

Imazhet, të cilat datojnë që nga gjysma e dytë e shekullit 4, janë zbuluar duke përdorur një teknikë të re laserike që u lejon restauruesve të djegin depozita të karbonatit të bardhë të kalciomit të dendur me shekuj pa i prishur ngjyrat magjepsëse të errëta të pikturave të groposura.

Teknika mund të revolucionarizojë mënyrën se si është kryer puna restauruese në kilometra të katakombeve që qëndrojnë nën Qytetin e Përtjetshëm ku të krishterët e hershëm i kanë varrosur baballarët e tyre.

Ikonat janë zbuluar në tavanin e një varri të një gruaje aristokrate romane në katakombin Santa Tecla, afër vendit ku thuhet se janë të varrosura mbetjet e apostullit Pal.

Roma ka një numër të dhomave të tilla të varrimit dhe ato janë atraksion i madh turistik, të cilat u japin vizitorëve një shikim në traditat e kishës së hershme kur të krishterët zakonisht janë persekutuar për shkak të besimit të tyre. Të krishterët e hershëm i kanë hapur katakombet përjashta mureve të Romës si varreza nëntokësore, pasi që varrimi ka qenë i ndaluar brenda mureve të qytetit dhe romakët paganë zakonisht janë kremuar.

Arti me të cilin janë dekoruar katakombet e Romës zakonisht ka qenë i thjeshtë dhe simbolik në natyrë. Katakombet e Santa

Tecla, megjithatë, përfaqësojnë disa prej evidencave më të hershme të devotshmërisë ndaj apostujve në krishterimin e hershëm, kanë thënë zyrtarët e Vatikanit.

"Katakombet e krishtera, derisa na japin vlera me trashëgiminë religjioze dhe kulturore, përfaqësojnë një dëshmi shprehëse dhe domethënëse të krishterimit në origjinën e vet," ka thënë Imzot Giovanni Carru, i dyti në Komisionin Papnor të Arkeologjisë së Shenjtë të Vatikanit, që ruan katakombet.

Qershorin e kaluar, Vatikanit ka bërë të ditur zbulimin e ikonës së Palit në Santa Tecla, duke koordinuar lajmin për të përkthyer me fundin e vitit të Shën Palit të shpallur nga Vatikanit. Papa Benedikti XVI gjithashtu ka thënë se testet në copëzat e eshtrave që i janë atribuar Palit "duket që janë konfirmuar" se ato në fakt i kanë takuar një shenjtë romano-katolik.

Të martën, arkeologët e Vatikanit kanë bërë të ditur se imazhi i Palit nuk është gjetur i izoluar, por ka qenë pjesë e një pikturë në tavanin e sheshtë që gjithashtu përmbante ikonat e tre apostujve të tjerë - Pjetrit, Gjonit dhe Andreut - të cilët e rrethojnë një imazh të Krishtit si Bari i Mirë.

"Ato janë ikonat e para. Këto janë absolutisht përfaqësimet e para të apostujve," ka thënë Fabrizio Bisconti, mbikëqyrësi i arkeologjisë për katakombet.

Bisconti ka folur nga brendia e dhomës së ngushtë të varrimit, muret dhe tavanin e cilës janë të mbuluara me piktura me skenat nga Testamenti i Vjetër, përfshirë Danielin në strofullin

“Mobile Archive” në Stacion

Stacion’ sjell në Prishtinë “Mobile Archive” me 1100 vepra arti nga Qendra për Arte Digjitale nga Izraeli

Prishtinë, 24 Qershor - Qendra për Arte Bashkëkohore “Stacion” duke filluar nga data 28 qershor në ora 20.00 do të hapë përka-

tësisht do të sjellë në Prishtinë “Mobile Archive” me 1100 vepra arti nga Qendra për Arte Digjitale nga Izraeli. Ky arkiv përfshin video-vepra, audio-vepra, filma, filma dokumentar, instalacion dhe performanca të artistëve të njohur bashkëkohorë nga ky arkiv që njihet si njëra ndër arkivat me të

njohura të video-veprave. Përveç sjelljes se veprave të artit, një ditë pas hapjes se këtij arkivi më datën 29 qershor ne ora 20:00 do të ketë një diskutim me themeluesen dhe drejtoreshën e Qendrës për Arte Digjitale nga Izraeli Galit Eilat, diskutim që do të jetë i hapur për audiencën do të

realizohet në bashkëbisedim me Albert Heten, artist dhe drejtor i Stacion. Përveç artistëve të tjerë të njohur ndërkombëtarë me veprat e tyre në këtë arkiv që ka udhëtuar edhe në qendra tjera të artit në botë janë pjesëmarrës me veprat e tyre edhe artistet shqiptar si

Sislej Xhafa, Anri Sala, Alban Muja, Erzen Shkololli dhe Adrian Paci. Te gjithë atë që janë të interesuar të i shohin veprat e artistëve të njohur do të kenë këtë mundësi deri më 24 korrik kur do të mbyllet kjo arkivë, e para e këtij lloji në Kosovë.

Albana S. Muja

IKONAT E SHENJTERVE

e luanëve dhe Abrahamin dhe flijimin e Isakut. Sapo të hyjnë brenda, vizitorët mund të shohin dhomat e varimit në tri anë.

Por perla është në tavan, ku katër apostujt janë të pikturuar brenda rrathëve të mbuluar me ar përkundër sfondit të kuq. Tavani gjithashtu është i dekoruar me vizatime gjeometrike dhe kornizat paraqesin imazhe të rinjve të zhveshur.


Restauruesja kryesore Barbara Mazzei ka pohuar se ka pasur imazhe më të hershme të Pjetrit dhe Palit, por këto janë përkruar në tregime. Imazhet në katakombe – me fytyrat e tyre, të rrethuara me ari dhe të ngulitura

në katër skajet e pikturës në tavan – janë të devotshme në llojin e tyre dhe si të tilla përfaqësojnë ikonat e para të njohura.

“Fakti i izolimit të tyre në një qosh na tregon se është një formë e devotshmërisë,” ka thënë ajo. “Në këtë rast, shenjtërit Pjetër dhe Pal, si dhe Gjoni dhe Andreu janë dëshmitë më të vjetra që kemi.”

Veç kësaj, imazhet e Andreut dhe Gjoni tregojnë fytyra më të reja sesa zakonisht janë përkruar në shëmbëlltyrat bizantine që shumë shpesh kanë qenë të lidhura me apostujt, ka thënë ajo.

Zyra e Arkeologjisë së Shenjtë të Vatikanit ka mbikëqyrur projektin dy vjeçar 60 mijë eurosh, që për



herë të parë janë vënë në përdorim laserët për t’i restauruar afresket në katakombe, ku ajri i njomë

e bënë më të vështirë procedurën. Në këtë rast, dhoma e vogël e varimit në fund të katakombit

është mbështjellë në rreth pesë centimetra me karbon të kalciu-mit. Teknologji e ngjashme është përdorur në statuja, pjesërisht metalike të dëmtuara gjatë viteve nga ndotja e jashtme.

Megjithatë, restaurimi në Santa Tecla ka shënuar herën e parë kur laserët janë adaptuar për përdorim në brenditë e njoma të katakombeve.

Pjesa më e madhe e katakombeve të Romës janë të hapura rregullisht për publikun. Megjithatë, katakombet e Santa Tecla do të jenë të hapura vetëm me kërkesë të një grupi të kufizuar për të ruajtur pikturat.

AP

KEK KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

SHTYRJËJE E AFATIT TË FUNDIT PËR DOREZIMIN E OFERTES:

Njoftohen ofertuesit e interesuar të cilët kanë bërë terheqjen e dokumentacionit për tenderin „Izolimi i kabinave të Ekskavatorit E-8M1“ me nr. të prokurimit KEKO 10 337 521, që afati për dorezimin e ofertave (28.06.2010, ora 14:00) i cili ka qenë i shpallur me 02.06.2010, shtyhet për datën 08.07.2010 në të njëjtën kohë. Mirepresim ofertën tuaj.

PRODUZENJE KRAJNJEG ROKA ZA PREDAJU PONUDE:

Obaveštavaju se zainteresovani ponudjači koji žele da podnesu ponudu za tender: „Izolacija kabine u Bageru E-8M1“, sa referencijom nabavke: KEKO 10 337 521, da je rok za predaju ponude (28.06.2010, 14:00 časova) za dotični tender, koji je bio objavljen 02.06.2010 god. produžuje se na dan 08.07.2010, na isto vreme. Očekujemo vašu ponudu.

KEK KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

CONTRACT AWARD NOTICE
SUPPLIES

According to Section 49 of Law No. 02/L-99, Law on Public Procurement in Kosovo, promulgated with Regulation No. 2007/20

Procurement No: KEKO 10 309 111

I: CONTRACTING AUTHORITY: Kosovo Energy Corporation (KEK) Jsc

II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1 Contract title attributed by the contracting authority: “SUPPLY WITH COMMUNICATION EQUIPMENT”

III TYPE OF PROCEDURE

Open Restricted Negotiated Price Quotation

III.2: CONTRACT AWARD CRITERIAS : The most economically advantageous tender

IV: CONTRACT AWARD

IV.4 Name and addresses of economic operator to whom the contract has awarded: ELTING ELEKTRONIKES PRISHTINA

IV.5 Information on value of contract: value of contract 99,901.95 € (including VAT)

V.1: COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Procurement Review Body, (address): str. Fehmi Agani 43 Prishtine, According to the provisions of Title VIII of Law No. 02/L-99, Law on Public Procurement in Kosovo, promulgated with Regulation 2007/20. Full version of the contract award notice is available in: www.ke-gov.net/krpp

KEK KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS FURNIZIM

Konform neni 39 të Ligjit nr.02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, të shpallur me Rregulloren Nr.2007/20 Nr. i Prokurimit: KEKO 10 309 111

I: AUTORITETI KONTRAKTUES Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) sh.a.

II: LËNDA E KONTRATËS

II.1 Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: “FURNIZIME RADIO LIDHJE”

III LLOJI I PROCEDURËS

E hapur E kufizuar E negociuar Kuotim i çmimeve

III.2 KRITERET PËR DHËNIE TË KONTRATËS: Tenderi ekonomikisht me i favorshëm

IV: DHËNIA E KONTRATËS

IV.4 Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të cilit i është dhënë kontrata: ELTING ELEKTRONIKES-PRISHTINE

IV.5 Informacione lidhur me vlerën e kontratës Vlera e kontratës 99,901.95 € (përfshirë TVSH-në).

V.1 ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit: Rr. Galibardi

Në bazë të dispozitave të Pjesës VIII të Ligjit nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë të shpallur me rregulloren nr. 2007/20.

Versioni i plotë i Njoftimit për dhënie të kontratës, është në dispozicion në: www.ke-gov.net/krpp

KEK KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS Sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA D.D.

OBAVEŠTENJE O DODELI UGOVORA SNABDEVANJE

Po členu 39 Zakona br. 02/L-99 o javnom nabavkama na Kosovu, objavljen Pravilnikom Br.2007/20

Br.Nabavke: KEKO 10 309 111

I: UGOVORNI AUTORITET: Energetska Korporacija Kosova d.d. (EKK)

II: PREDMET UGOVORA

II.1 Naslov ugovora koji je dodelio ugovorni autoritet: “SNABDEVANJE SA RADIO VEZE”

III VRSTA PROCEDUR

Otvorena Ograničena Pregovaranja Kvotiranje cena

III.2 KRITERIJUMI ZA DODELU UGOVORA: Odgovarajući tender sa Ekonomski najpovoljniji tenderu smislu

DEO IV: DODELA UGOVORA

IV.4 Ime i adrese ekonomskog operatera kojem je dodeljen ugovor: “ELTING ELEKTRONIKES” PRISHTINA

IV.5 Informacije o vrednosti ugovora Vrijednost ugovora 99,901.95 € (sa PDV-om)

V.1 ŽALBE

Svaka zainteresovana stranka može da preda žalbu Organi za Razmatranje Nabavki: UL

Na osnovu dispozicija Dela VIII Zakona br. 02/L-99 o javnim nabavkama na Kosovu, objavljen Pravilnikom Br.2007/20

Kompletan verzija Obaveštenja Ugovora je na raspolaganju: www.ke-gov.net/krpp



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

NJOFTIMI PËR KONTRATË-FURNIZIM
(afatet normale kohore)-ritenderim

Konfirmim nëntë 38 të Ligjit Nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, të shpallur me Rregulloren Nr.2007/20

Nr. i Prokurimit: **KKSP-10-066-121** Data : **24.06.2010**
I AUTORITETI KONTRAKTUES: KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS
II LËNDA E KONTRATËS
 II.1.1 Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
FURNIZIMI ME FLAMUJ TË SHITETEVE TË BOTES PËR NEVOJAT E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
 II.1.2 Lloji i kontratës dhe lokacioni i dorëzimit të furnizimeve -Kuvendi i Republikës së Kosovës-kontratë afatgjate -1 vit + vit
 II.1.3 Informacione të marrëveshjes komizë:
III INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE
 III.1 Sigurimi i ekzekutimit :10 %
IV.2 KRITERET E DHËNIES SË KONTRATËS: Çmimi më i ulët
IV.3 INFORMACIONET ADMINISTRATIVE
 IV.3.2 Kushtet për marrjen e dosjes së tenderit / dokumenteve para-kualifikuese
 Afati i fundit për pranimin e kërkesave për dosjen e tenderit / dokumenteve para-kualifikuese:
 data: **19.07.2010 ora 15:00**
 Dokumentet me pagesë: Po Jo
 IV.3.3 Afati kohor për pranimin e tenderëve / kërkesave për pjesëmarrje:
 data :**20.07.2010 koha: 14:00 h, vendi Zyra e prokurimit Nr. 223**
 IV.3.5 Sigurimi i tenderit: 1.000.00 €
 IV.3.8 Takimi për hapjen e tenderëve:
 Data: **20.07.2010 koha: 14:30 vendi: Zyra e prokurimit Nr. 223**
NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE: 14.07.2010 ora 15:30
V.1 ANKESAT
 Çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit:
 (shëno adresën e plotë): _____
 Në bazë të dispozitave të Pjesës VIII të Ligjit Nr 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, të shpallur me Rregulloren nr. 2007/20.
 Versioni i plotë i Njoftimit për Kontratë është në dispozicion në: www.ks-gov.net/krpp



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

OBAVEŠTENJE O UGOVORU- SNABDEVANJE
(Normalski vreme rokovi)- ponovo tenderiranje

Po çlenu 38 Zakona br. 02/L-99 o javnim nabavkama na Kosovu, objavljen Pravilnikom Br.2007/20

Br.Nabavke: KKSP-10-066-121 ; datum :24.06.2010
I: UGOVORNI AUTORITET : Skupština Republike Kosovo
II: PREDMET UGOVORA
 II.1.1 Naslov ugovora koji je dodelio ugovorni autoritet:
Snabdevanje sa svetskim zastavama za upotrebu Skupština Republike Kosovo
 II.1.2 Vrsta ugovora I lokacija predavanja snabdevanja
 II.1.3 Informacije o okvirnom sporazumu:
III PRAVNE, EKONOMSKE, FINANSIJSKE I TEHNICKE INFORMACIJE
III.1 Osiguranje tendera :10 %
DEO IV.2 : KRITERIJUMI DODELE UGOVORA: Najniža cena,
IV.3 ADMINISTRATIVNE INFORMACIJE
 IV.3.2 Uslovi za uzimanje tenderskih dosijea i prekvalifikovanih dokumenata
 Zadnji rok za prijem zahteva za tenderski dosije:
datum: 19.07.2010 časova 15:00
 Dokumenti sa plaćanjem: da X ne. Ako da, cena:
 IV.3.3 Vremenski rok za prijem tendera ili zahteva za učešće
datum 20.07.2010 vreme 14:00
IV.3.5 siguranje tendera :1.000.00 €
 IV.3.8 Sastanak za otvaranje tendera
Datum: 20.07.2010 vreme 14:30
V.1 ŽALBE
 Svaka zainteresovana stranka može da preda žalbu Organu za Razmatranje Nabavki:
 (adresa) _____
 Na osnovu dispozicija Dela VIII Zakona br. 02/L-99 o javnim nabavkama na Kosovu, objavljen Pravilnikom Br.2007/20
 Kompletan verzija Obaveštenja Ugovora je na raspolaganju: www.ks-gov.net/krpp



POLICIA E KOSOVËS

NJOFTIM PËR ANULIMIN E AKTIVITETIT TË PROKURIMIT
Konfirmim nëntë 39 A të Ligjit nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë të shpallur me Rregulloren nr.2007/20

Nr. i Prokurimit: **214/ 10/ 06/ 121**
I AUTORITETI KONTRAKTUES: POLICIA E KOSOVËS , Rr.Luan Haradinaj pn.
II LËNDA E KONTRATËS
 II.1.1 Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues: **MRUSHJA E KLIMAVE TË AUTOMJETEVE ME GAS DHE REGLAZHIMI- RITENDER**
IV ANULIMI I PROCEDURËS
 IV.1 Data e vendimit mbi anulimin e procedurës: 15.06.2010
 IV.2 Numri i tenderëve të pranuar : 02
 IV.3 Arsyeya e anulimit të procedurës së prokurimit publik: Nuk janë tri oferta të përgjegjshme
NENI V: ANKESAT
 Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit: Rr.Garibaldi pn.
 Në bazë të dispozitave të Pjesës VIII të Ligjit nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, të shpallur me Rregulloren nr. 2007/20.
 Versioni i plotë i Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit është në dispozicion në: www.ks-gov.net/krpp


POLICIJA KOSOVA

OBAVEŠTENJE O OTKAZIVANJU AKTIVNOST RADA
Po členu 39 A Zakona br.02/L-99 o javnim nabavkama na Kosovu, objavljen Pravilnikom Br.2007/20

Nabavka br. 214/10/06/121

I: UGOVORNI AUTORITET : POLICIJA KOSOVA UL. "Luan Haradinaj" bb
II: PREDMET UGOVORA
 II.1.1 Naslov ugovora koji je dodelio ugovorni autoritet: **PUNJENJE KLIMA U VOZILIMA SA GASOM I REGLAŽA- Ritender**

IV PROCEDURA OTKAZIVANJA
 IV.1 Datum odluke o otkazivanju procedure: 15.06.2010
 IV.2 Broj prijavljenih tendera :02
 IV.3 Razlog otkazivanja procedure javne nabavke: **Primitjena su manje od 3 odgovarajuća tendera ili zahteva za učesće: nijedna posuda**
DEO V: ŽALBE
 Svaka zainteresovana strana može da uložiti žalbu Telu za preispitivanje nabavke:
 (adresa) "Garibaldi" bb , Priština,
 Po odredbama Dela VIII Zakona br. 02/L-99 o javnim nabavkama na Kosovu, objavljen Pravilnikom Br.2007/20
 Kompletan verzija Obaveštenja o Konkursu za Idejni Projekat je na raspolaganju i
www.ks-gov.net/krpp



NJOFTIM PËR DHËNIE TË KONTRATËS- FURNIZIME
Konfirmim nëntë 39 të Ligjit nr.02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë, të shpallur me Rregulloren Nr.2007/20

Data: **23/06/2010**
 Nr. i Prokurimit: **EK 104 10 053 121**
I AUTORITETI KONTRAKTUES: ZYRA E KRYEMINISTRIT, SHESH "NËNË TEREZA" PN. PRISHTINË
II: LËNDA E KONTRATËS -
 Furnizim me vetura për AKI-në.
III.1 LLOJI I PROCEDURËS - E hapur X
III.2 KRITERET PËR DHËNIE E KONTRATËS - "Çmimi më i ulët"
IV: DHËNIA E KONTRATËS
 Në rast të disa pjesëve të dhëna disa operatorëve ekonomik të suksesshëm, përsërit § IV.4 dhe IV.5 për secilin pjesë.
 IV.4 Emri dhe adresa e operatorit ekonomik të cilit i është dhënë kontrata:
 „ AHP” Rr. „ Ujqinal “ Nr. 35 Prizren 20 000
IV.5 Vlera e përgjithshme përfundimtare e kontratës: € 98.000.00

V.1 ANKESAT
 Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit:
 Emri shtetar: **ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**
 Adresa e OSHP-së: **Te Grandi- Rruga "GARIBALDI" pa nr.** Kodi postar: 10000
 Qyteti: **Priština**
 Personi kontaktues: **Ardian Behra** E-mail: **ardian.behra@ks-gov.net**
 Telefoni: **038/213 378** Faksi: **038/213 378**

Në bazë të dispozitave të Pjesës VIII të Ligjit nr. 02/L-99, Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë të shpallur me rregulloren nr. 2007/20.
 Versioni i plotë i Njoftimit për dhënie të kontratës, është në dispozicion në:
www.ks-gov.net/krpp

OBAVEŠTENJE O DODELI UGOVORA - SNABDEVANJE
Po členu 39 zakona br.02/L-99zakona zar Javne Nabavke na Kosovu, objavljen Uredbom Br.2007/20

Datum: 23/06/2010
 Nr. i Prokurimit: **EK 104 10 053 121**
I: UGOVORNI AUTORITET: URED PREMIJERA, TRG "NENE TEREZA" BB.PRIŠTINA
II: PREDMET UGOVORA - Naslov ugovora koji je dodelio ugovorni autoritet:
Snabdevanje vozilima za OAK-a.
III.1 VRSTA PROCEDURE - Otvorena X
III.2 KRITERIJE O DODELI UGOVORA - "Najniža cena"
IV: DODELA UGOVORA
 U slučaju počeće pojedinih Ugovora nekoliko uspešnih Ekonomskih Operatera, ponoviti § IV.4 i § IV.5 za vaki deo.
 IV.4 Ime i adresa ekonomskog operatera kojem je dodeljen ugovor
 "AHP" UL " Ujqinal" br. 35 Prizren 20 000.
IV.5 Ukupna vrednost ugovora : € 98.000.00

V.1 ŽALBE
 Svaka zainteresovana strana može da uložiti žalbu
 Tela za Preispitivanje Nabavke.
Službeni naziv: TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
 Adresa TRN-a: Ulica "GARIBALDI" bb.
 Grad: **Priština** Poštanski broj: 10000
 Lica za kontakt: **Ardian Behra** E-mail: **ardian.behra@ks-gov.net**
 Telefon: **038/213 378** Faks: **038/213 378**

Po odredbama Glave VIII zakona br. 02/L-99, ZJN na Kosovu , objavljen Uredbom Br.2007/20
 Puna verzija obaveštenja o dodeli ugovora, možete naći:
www.ks-gov.net/krpp

Expressport

BOTËRORI AFRIKA

e Jugit 2010



- » Bunjaku realizon ëndrrën
- » Faji i diktatorit
- » Beckenbauer:
Anglezët budallenj

Italianët mund të kthehen në shtëpi, të hanë Pizza Ciao dhe ta ndjekin vazhdimin e Botërorit në televizion. Ata nuk kanë tjetër mundësi, pasi u rrëzuan në grupe. Mund të ngushëllohen pak nëse i shikojnë ndeshjet në HD, që t'u duket sikur janë në Afrikë. Festa nga Grupi F i takoi Paraguait dhe Sllovakisë.

PIZZA CIAO

» MOTORËT E JAPONISË

» SHBA NUK NDALET

Ballack, afër vendimit

Mesfushori i Kombëtares gjermane, Michael Ballack ka bërë të ditur se brenda dy javëve të ardhshme do të merr vendim se ku do të luajë në sezonin e ri. 33 vjeçari është liru nga Chelsea pas përfundimit të

edicionit të fundit, ndërsa mungon në Kampionatin botëror në Afrikën e Jugut për shkak të një lëndimi në nyjën e këmbës. Ballack spekulohet se kërkohet nga një numër i klubeve në Gjermani, përfshirë

ish ekipin e tij Bayer Leverkusen. Mirëpo, në garë thuhet se është edhe klubi spanjoll Sevilla. "Konfirmoj se do të marr vendim së shpejti. Brenda dy javëve të ardhshme do të vendos rreth të ardhmes

sime", tha Ballack për të përditshmen sportive gjermane Bild. Ballack kaloi katër sezona në Chelsea pasi kishte bërë emër në Bundesligë, së pari me Bayer Leverkusenin e pastaj në Bayern Munich.



Motorët e Japonisë



Japonia shfaqti paraqitje të shkëlqyeshme dhe fitoi 3-1 ndaj Danimarkës në ndeshjet e fundit të Grupit E, ndërsa siguroi kualifikimin për në fazën e dytë të Kampionatit botëror. Holanda mposhti Kamerunin 2-1 dhe përfundoi e para në grup me pikë maksimale.

Holanda dhe Japonia janë kualifikuar për në fazën e dytë të Kampionatit botëror të enjten, derisa Danimarka dhe Kameruni janë eliminuar nga gara. Holanda, që mposhti Kamerunin 2-1 në Cape Town, përfundoi e para në Grupin E dhe do të takohet me Sllovakinë në rrethin e dytë të hënën në Durban. Ndërsa Japonia mposhti Danimarkën 3-1 në Rustenburg dhe do të përballlet me Paraguain në Pretoria të martën. Japonisë iu nevojit vetëm një barazim kundër Danimarkës për të kaluar në fazën e dytë, mirëpo ata filluan takimin furishëm dhe kaluan në epërsi 2-0 pas përfundimit të pjesës së parë me golat e realizuar nga dy goditje të lira; i pari nga një distancë prej mbi 30 metra që u shndërrua në gol nga Keisuke Honda në minutën e

17-të, ndërsa i dyti pas një goditjeje mjeshtërore afër zonës nga Yasuhito Endo. Danimarka u rikthye në lojë 10 minuta para përfundimit të ndeshjes, kur portieri japonez Eji Kawashima e priti goditjen e Jon Dahl Tomassonit nga penalltia, mirëpo sulmuesi realizoi pas topit të rikthyer. Japonia vulosi fitoren duke shënuar golin e tretë nëpërmjet Shinji Okazakit, tre minuta para përfundimit të ndeshjes. Danimarka e filloi mirë takimin, por humbi kontrollin nga Japonia që u bë ekipi i dytë aziatik i cili pas Koresë së Jugut siguroi kalimin në fazën e dytë. Në ndeshjen tjetër, Holanda realizoi fitoren e tretë nga po aq ndeshje dhe siguroi pozitën e parë në Grupin E. Pas fitoreve ndaj Danimarkës dhe Japonisë, Tulipanët mposhtën edhe

Kamerunin me golat nga Robin van Persie dhe Klaas Jan Huntelaar. Golin e vetëm për Kamerunin e shënoi Samuel Eto'o nga penalltia. Holanda ka përfaqësuar më së miri ekipet evropiane në fazën e grupeve duke dominuar Grupin E, ndërsa Kameruni përfundoi i fundit dhe dështoi të realizojë objektivin e kualifikimit në Botërorin e parë në kontinentin e Afrikës.

Grupi E	
Rezultatet	
Danimarka-Japonia	1:3
Kameruni-Holanda	1:2

Tabela	
Holanda	3 9
Japonia	3 6
Danimarka	3 3
Kameruni	3 0

Italianët mund të kthehen në shtëpi, të hanë Pizza Ciao dhe ta ndjekin vazhdimin e Botërorit në televizion. Ata nuk kanë tjetër mundësi, pasi u rrëzuan në grupe. Mund të ngushëllohen pak nëse i shikojnë ndeshjet në HD, që t'u duket sikur janë në Afrikë. Festa nga Grupi F i takoi Paraguait dhe Sllovakisë.

Kampioni i Botës, Italia, është eliminuar në mënyrë të turpshme nga Kampionati botëror. Azzurrët i befasoi autsajderi Sllovakia, që ia doli të triumfojë në përballje (3:2) e cila pati përfundim dramatik.

Sllovakia, e cila do të vazhdojë garën, më mirë e nisi takimin dhe dominoi përballë italianëve në posedim të topit. Si rrjedhojë e kësaj, sllovakët pjesën e parë të ndeshjes e përmbyllën në favor të tyre me rezultat 1:0. Këtë gol e shënoi Robert Vittek në minutën e 25-të të takimit.

Gjatë kësaj pjesë-loje sllovakët i kanë pasur edhe tri raste tjera të mira shënimi nëpërmjet Marek Hamsikut, Zdeno Strbas dhe Juraj Kucka. Kurse, Italia shumë lehtë ka mundur ta barazojë rezultatit në minutat shtesë të pjesës së parë, kur mbrojtësi sllovak, Martin Skrtel për pak sa nuk shënoi autogol me kokë.

Italia në pjesën e dytë luajti më mirë sesa në periudhën e parë të ndeshjes, duke sulmuar më tepër. Kështu, në minutën e 55-të Vincenzo Iaquinta doli përballë portierit sllovak, por gjuajti jashtë portës.

Në minutën e 66-të, Fabio Quagliarella gjuajti fuqishëm, por topin nga vija e fundit e portës e largoi mbrojtësi sllovak Skrtel, duke evituar me këtë rast gol të sigurt. Madje, me këtë rast dukej se topi veç kishte kaluar vijën e fundit, por kështu nuk menduan edhe gjyqtarët e ndeshjes.

Sllovakia në minutën e 73-të i solli kokëçarje Italisë, pasi e shtoi



Pizza

epërsinë e saj në 2:0 me golin që e shënoi Vittek. Por, italianët nuk u dorëzuan dhe ia dolën ta ngushëtojnë epërsinë e ekipit kundërshtar në 2:1 në minutën e 81-të me golin që e shënoi Antonio di Natale. Nga ky moment ndeshja ishte jashtëzakonisht interesante, sepse Italia kërkonte ta shënojë golin e barazimit, i cili edhe do ta kualifikonte nga faza e grupeve.

Di Natale shënoi më pas edhe një gol, por u anulua nga gjyqtarët me arsyetimin se goli u shënuar nga pozita jashtë loje. Kur as nuk pritej se sllovakët do të shënojnë gol sërish, Kamil Kopunek me të hyrë në ndeshje shënoi për rezultat 3:1.

Megjithatë, Italia shënoi edhe një gol në minutën e dytë të lojës shtesë, për rezultat 3:2. Këto gol

Saifi godet një gazetare

Një gazetare ka thënë se futbollisti algjerian Rafik Saifi e ka goditur në fytyrë, pas eliminimit të ekipit të tij nga Kampionati botëror. Algjeria u mposht 1-0 nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në ndeshjen e fundit të tyre në Grupin C dhe përfundoi pjesëmarrjen me vetëm një pikë. "Isha duke

pritur futbollistët algjerianë. Kur erdhi Saifi unë jam larguar pak, por ndjeva një goditje", tha Asma Halimi për BBC. Gazetarja e cila punon për të përditshmen algjeriane Competition, ka thënë se ajo kishte pasur mosmarrëveshje me Saifin një vit më parë. "Do të ankohehem në FIFA dhe në polici", shtoi ajo.



Za Ciao

të bukur e realizoi Fabio Quagliarella. Loja u shty shtatë minuta shkaku i ndërprerjeve të shumta, kryesisht stimulimeve të futbollistëve slovakë, me qëllim të përfitimit në kohë, sepse Italia nuk ndalej të sulmuari.

Rastin e fundit e pati Simone Pepe, por gjuajtja e tij shkoi jashtë portës dhe ndeshja përfundoi me rezultat 3:2 në favor të Sllovakisë.

Duhet theksuar se mbrojtja italiane edhe në këtë takim, sikurse dy ndeshjet e tjera të mëparshme, nuk ishte në nivel të detyrës, derisa në të kaluarën italianët ishin shembull për mbrojtje të fortë.

Italianët që përfunduan në vendin e fundit në Grupin F, mund të kthehen në shtëpi, të hanë Pizza Ciao dhe ta ndjekin vazhdimin e Botërorit në televizion.

Ndërsa në takimin tjetër, Para-

guait i mjaftoi edhe një barazim në ndeshjen e fundit në kuadër të fazës së grupeve për kualifikim. Paraguai të enjten është takuar me Zelandën e Re, ndeshje kjo që përfundoi me rezultat 0:0. Mirëpo, Paraguai ka mundur edhe të fitojë në këtë takim, sepse përveç që ka dominuar në posedim të topit, ka pasur edhe disa raste të mira shënimi.

Grupi F		
Sllovakia – Italia	3:2	
Paraguai – Zelandë e Re	0:0	

Tabela		
Paraguai	3	5
Sllovakia	3	4
Zelandë e Re	3	3
Italia	3	2

Portugalia – Brazili (16:00)

Portugalia dhe Brazili përballesh në premtën për të drejtën e hyrjes në fazën e dytë si fitues të Grupit G. Të dyja ekipet kanë bërë mjaft për të siguruar kalimin në mesin e 16 ekipeve më të mira në Kampionatin botëror, ku Brazili tashmë e ka të garantuar kalimin.

Saleçao ka pikë maksimale pas dy ndeshjeve me fitoren 2-1 ndaj Koresë së Veriut dhe 3-1 ndaj Bregut të Fildishtë, andaj edhe vetëm një pikë nga takimi i ardhshëm ua siguron pozitën e parë. Portugalia është



aktualisht e dyta me katër pikë dhe i nevojitet vetëm edhe një pikë për të siguruar kualifikimin. Mirëpo, ata mund të mposhten dhe prapë të vazhdojnë garën pasi fitorja e thellë 7-0 ndaj

Koresë së Veriut u ka siguruar golaverazh superior ndaj Bregut të Fildishtë – i vetmi ekip që mund t'ua përfundojë aventurën në Botëror. Carlos Queiroz do të jetë optimist në rezultat

pozitiv, pasi ekipi i tij është i pamposhtur në 17 ndeshjet e fundit. Portugalia do të synojë të hakmerret për humbjen 6-2 nga Brazili në përballjen e tyre të fundit në miqësoren e vitit 2008.

Koreja e Veriut – Bregu i Fildishtë (16:00)

Bregut të Fildishtë i nevojitet një mrekulli kundër Koresë së Veriut për të kaluar në fazën e dytë të Kampionatit botëror. Ekipi i Sven Goran Erikssonit duke se do të kualifikohej nga Grupi G pas barazimit pa gola kundër Portugalisë në takimin e parë. Mirëpo, humbja 3-1 nga Brazili të dielën goditi shpresat e tyre dhe dëmi më i madh u bë një ditë më vonë, kur Portugalia e shkatërroi Korenë e Veriut 7-0. Bregu i Fildishtë duhet të mposhtë Korenë e Veriut dhe të

varet nga Brazili t'i bëjë nder e të mposhtë Portugalinë. Por edhe kjo nuk mjafton për të kaluar grupin për shkak të golaverazhit superior të Portugalisë (+7), ndërsa ekipi afrikan është në minus 2. Megjithatë, Bregu i Fildishtë duhet të ruajë optimizmin para ndeshjes në Nelspruit dhe të besojë se mund të shënojë fitore bindëse. Eriksson do të këshillojë futbollistët e tij të adaptojnë lojë më ofensive sesa në dy takimet e para.



Kili – Spanja (20:30)

Spanja duhet të fitojë ndeshjen e tyre të fundit në Grupin H kundër Kilit, për të siguruar kualifikimin në fazën e dytë. Kampioni evropian i vitit 2008 pritej të kalonte grupin me lehtësi për të arsyetuar epitetin e favoritit në Kampionatin botëror. Mirëpo, kampanja filloi me vështirësi dhe Spanja me përfundim në pozitën e dytë mund të takohet me Brazilin. Humbja 1-0 nga Zvicra ishte e papritur, por ekipi nuk krijoi raste të mjaftuara për shënim, edhe pse dominoi në posedim të topit, ndërsa helvetikët shfrytëzuan



rastet e pakta dhe morën tri pikë të arta për ta. Mirëpo, ekipi i Vicente del Bosques u rikthye në garë për kualifikim pas fitores 2-0 ndaj Hondurasit, edhe pse

kanë mundur të shënojnë më tepër gola, por Fernando Torres nuk konkretizoi rastet e shumta që pati dhe heroi i dy golave, David Villa nuk shënoi nga penalltia. Forma jo e mirë e Torresit para portës kundërshtarre është brengë e madhe e Spanjës. Kili është lider i grupit me gjashtë pikë nga dy ndeshje, andaj me barazim do të siguron kalimin në fazën e dytë. Mirëpo, ata mund të shkojnë përpara edhe nëse humbin, ndërsa takimi tjetër mes Zvicrës dhe Hondurasit përfundon baras, me fitore të Hondurasit.

Zvicra – Hondurasi (20:30)

Zvicra do të shpresojë në sigurimin e kualifikimit për në fazën e dytë të Kampionatit botëror, kur takohet me Hondurasin të premtën. Helvetikët filluan furishëm në Grupin H me fitore 1-0 ndaj Spanjës. Mirëpo, ata u mposhtën 1-0 nga Kili në takimin e dytë të grupit dhe aktualisht gjenden në pozitën e tretë me Kilin dhe Spanjën para tyre. Kualifikimi në fazën e dytë është i rrezikuar, pasi nevojiten favore nga takimi tjetër mes Kilit dhe Spanjës. Zvicra duhet të mposhtë



Hondurasin me më tepër se një gol dallim, por fatin e tyre mund ta përcaktojë edhe takimi tjetër i grupit. Nëse Kili mposht Spanjën, atëherë Zvicrës i mjafton edhe

një barazim kundër Hondurasit për t'u kualifikuar. Ndërsa nëse fiton Spanja, do të vendosë golaverazhi – në rast të fitores së Zvicrës. Barazimi (Kili-Spanja) do t'i mundësonte ekipit të Hitzfeldit të kalonte Spanjën nëse mposht Hondurasin. Mesfushori kosovar Valon Behrami është i suspenduar pas përjashtimit në ndeshjen e kaluar kundër Kilit, mirëpo në dispozicion janë dy kosovarët e tjerë; Alberto Bunjaku dhe Xherdan Shaqiri.



Milito vazhdon në Inter

Sulmuesi argjentinas Diego Milito do të nënshkruajë kontratë të re me Interin deri në vitin 2014, ka njoftuar e përditshmja sportive italiane Gazzetta dello Sport. Milito spekulohet se mund të largohet nga klubi dhe t'i bashkohet Real Madridit të ish trajneri i tij

nga Inter, Jose Mourinho. Mirëpo, njoftimet më të reja nga Italia sugjerojnë se Milito do të vazhdojë kontratën e tij me Nerazzurrit deri më 2014. Marrëveshja pritet të finalizohet pas rikthimit të tij në Milano nga Kampionati botëror në Afrikën e Jugut.

Iniesta mirëpret ardhjen e Matas

Ylli i Barcelonës, Andres Iniesta ka mirëpritur mundësinë e transferimit të mesfushorit të Valencias, Juan Mata. Mata është objektiv i gjigantit katalan dhe trajneri Pep Guardiola thuhet se është i gatshëm të ofrojë 20 milionë euro për reprezentuesin spanjoll. Ndërkohë, Iniesta ka përkra-

hur ardhjen e Matas në Nou Camp. "Ai ka luajtur shkëlqyeshëm me Valencian. Tani është njëri prej futbollistëve më të kërkuar në tregun evropian. Kam marrëdhënie shumë të mira me të në Kombëtaren e Spanjës dhe do të doja që ai të vinte në Barcelonë", tha Iniesta.

Lichtsteiner vajton përjashtimin e Behramit



Mbrojtësi zviceran, Stephan Lichtsteiner e ka kundërshtuar vendimin e gjyqtarit, pas të cilit Valon Behrami u detyrua ta lëshojë fushën para kohe në ndeshjen që Zvicra e zhvilloi ndaj Kilit para pak ditëve në Afrikën e Jugut.

Futbollisti i West Hamit u ndëshkua me kartuç të kuq në atë takim, pasi e goditi me dorë në fytyrë – pa qëllim – lojtarin kilian Arturo Vidal në pjesën e parë të asaj ndeshjeje, në të cilën Zvicra pësoi humbje me rezultat minimal 1:0.

Për këtë 25 vjeçari nga Kosova do të mbetet jashtë ndeshjes vendimtare të së premtes, që Zvicra e zhvillon ndaj

Hondurasit në kërkim të tetës së finales së Botërorit 2010.

"Behrami i ka ngritur duart lart që ta mbrojë topin, pasi ishte sulmuar nga disa lojtarë kilianë, por ai nuk e ka goditur apo shtyrë lojtarin Vidal. Pastaj kiliani, me reagimin e tij, bëri që gjyqtari të besonte se Behrami e ka goditur në fytyrë", ka deklaruar mbrojtësi i Lazios, Stephan Lichtsteiner. Edhe vetë Vidal, pas asaj ndeshjeje, thoshte se ishte befarsuar me vendimin e gjyqtarit kur e pa gjyqtarin duke e nxjerr kartonin e kuq nga gjepi për ta ndëshkuar Behramin. Ky ishte një ngushëllim për Behramin

Albert Bunjaku e realizoi ëndrrën e tij, pasi luajti 13 minuta për përfaqësuesen e Zvicrës në përballje me Kilin. Sulmuesi kosovar po e shijon në maksimum eksperiencën fantastike në Afrikën e Jugut. Ai shpreson që ta ketë një rast tjetër në ballafaqimin e së premtes kundër Hondurasit.

Albert Bunjaku po kalon çastet më të mira në karrierë. Pas një sezoni të shkëlqyer në Bundesliga me Nurnbergun, sulmuesi kosovar ditë më parë e realizoi ëndrrën e tij – luajti në Kampionat botëror për Zvicrën në përballje me Kilin, në kuadër të Grupit H.

Gjilanasia luajti 13 minuta dhe për atë periudhë shfaqti shenja pozitive. 26 vjeçari po e shijon në maksimum eksperiencën e shkëlqyer të tij në Afrikën e Jugut. Zvicra do të luajë të premten me Hondurasin në ndeshjen e fundit të grupit, e cila është mjaft e rëndësishme.

Bunjaku shpreson që edhe në këtë lojë, selektori Ottmar Hitzfeld t'ia japë një minutazh. "13 minutat e debutimit në Botëror nuk do t'i harroj kurrë. Mëkat që nuk nxorëm pikë ndaj Kilit. Shpresoj që ta kem një mundësi të re kundër Hondurasit", tha ai për tabloidin gjerman Bild.

Angazhimet që ka me përfaqësuesen zvicerane nuk ia mundësojnë Bunjakut dhe shokëve të tij ta shijojnë kulturën dhe jetën afrikane. Por, ai tregon se e ka ndërmend të rikthehet sërish në kontinentin e Afrikës së Jugut për pushime verore.

Sulmuesi kosovar po ashtu ndihet i kënaqur me sigurinë atje. "Këtu njerëzit janë të shoqërueshëm dhe mundohen të të ndihmojnë. Ende nuk e njoh askënd që është gjendur në një situatë kritike këtu", nënvizoi ai.

Bashkë me Albert Bunjakun në Afrikën e Jugut gjendet edhe bashkëshortja e tij, Arjeta dhe djali, Dioni. Ajo i përcjell rregullisht ndeshjet e Botërorit, sidomos ato të Zvicrës, kurse Dioni i vogël kryesisht



REALIZ NJË EN

rri në hotel.

Ish futbollisti i Erfurt thotë se atmosfera nëpër stadione është e shkëlqyer, përkundër zhurmës së vuvuzelave. Fitorja ndaj kampionit të Evropës, Spanjës, shton Bunjakun, e ka gëzuar pa masë popullin zviceran, e në veçanti futbollistët, të cilët përjetuan një festë të vërtetë.

“Mendoj se kampion do të jetë Spanja, pa marrë parasysh humbjen nga ne. Më pas janë aty edhe Brazili dhe Argjentina.”

Albert Bunjaku

FOTOEXPRESS



Ish presidenti i Shteteve të Amerikës, Bil Clinton, i shoqëruar nga presidenti i FIFA's, Sepp Blatter, të mërkurën ka përcjellë ndeshjen ndërmjet SHBA-së dhe Algjerisë 1:0. I kënaqur me lojën e zhvilluar, miku i Kosovës ka vendosur të qëndrojë në Afrikën e Jugut edhe për ndeshjen e ardhshme që Amerika do ta zhvillojë kundër Ganës në fazën e dytë të Botërorit. | FOTO: REUTERS

Rehagel jep dorëheqje

Zyrtarë të Federatës së Futbollit të Greqisë kanë konfirmuar se trajneri Otto Rehagel ka dhënë dorëheqje nga detyra e tij, pas eliminimit nga Kampionati botëror, përcjell agjencia e lajme-

ve Reuters. Trajneri gjerman ishte emëruar në drejtim të Greqisë më 2001 dhe befasoi botën e futbollit kur udhëhoqi ekipin drejt triumfit në Euro 2004. Zyrtarë të Federatës konfirmuan largi-

min e Rehagelit pas rikthimit të ekipit në Greqi të enjten. Rehagel nuk ishte kthyer me ekipin. Ende nuk është bërë e ditur se kush do të jetë pasardhësi i tij, mirëpo, sipas medieve greke, trajneri

portugez Fernando Santos spekulohet se mund të jetë selektor i ri. Greqia u eliminua nga Kampionati botëror pas humbjes 2-0 nga Argjentina në ndeshjen e tyre të fundit në Grupin B.



ZIMI I NDRRE

Bunjaku ka shpalosur edhe emrat e skuadrave që mund ta fitojnë Botërorin, sipas tij. "Mendoj se kampion do të jetë Spanja, pa marrë parasysh humbjen nga ne. Më pas janë aty edhe Brazili dhe Argjentina", vazhdoi ai.

Pasi ta përfundojë aventurën në Afrikën e Jugut, Bunjaku do t'i rikthehet jetës normale. Ai do t'i fillo-

jë përgatitjet me skuadrën e tij Numberg për sezonin e ardhshëm. "Para se gjithash, shpresoj që të mbetem sa më gjatë të jetë e mundur në Afrikën e Jugut. Më pas kam nevojë për një pushim të shkurtër. Para fillimit të sezonit në Bundesliga kam paksa frikë, siç kisha për Kombëtaren para se të fillonte ky kompeticion", përfundoi Bunjaku.

Birra, çelësi i fitores

Fabio Capello ka zbutur rregullat e tij strikte. Ai ftoi lojtarët e përfaqësueses angleze për një birrë para ndeshjes me Slloveninë dhe rezultati ishte 1-0. Por, nëse lojtarët do pinin më shumë birra, ndoshta rezultati do të ishte edhe më i lartë.



Në ndeshjen kundër Sllovenisë të luajtur të mërkurën, Fabio Capello zbuloi sekretin e suksesit – ai lejoi lojtarët për të pirë një birrë para se të eliminonin Slloveninë.

Trajneri dinak – i cili u akuzua se është shumë strikt – ka zbutur rregullat e tij për të ndihmuar yjet e tij të relaksohen.

Ai ka thirrur Rooneyin, Gerrardin dhe shokët e tyre për ta lagë fytyrën bashkë me skuadrën në hotel.

Taktika e tij "birra për fitore" është paguar dhe Anglia ka bërë paraqitjen më të mirë në Botëror për të kaluar në mesin e 16 skuadrave më të mira.

Pas tyre edhe mijëra tifozë anglezë, të cilët shikuan ndeshjen në Port Elizabeth, kanë ngritur gotat lart për skuadrën.

Ata kanë pirë pijen e preferuar në një kafe në liman të qytetit që

quhet "News".

Shumicës prej tyre iu shpague qëndrimi në Afrikën e Jugut – përderisa kanë pirë birrën vendore "De Beers".

Mandej ata kanë kënduar himnin e tyre me titullin "Lightning Seeds' Three Lions" me refrenin: "Nuk shkojmë në shtëpi, ne nuk shkojmë në shtëpi".

"Babagyshi" italian i skuadrës buzëqeshte më të madhe kur është pyetur pse Anglia luajti më mirë sesa në dy ndeshjet e saj të mëparshme.

"Bëra diçka ndryshe. Mbrëmë kemi pirë birra. Pyesni edhe ata", tha italianin.

Ish kapiteni i skuadrës John Terry ishte njëri prej lojtarëve që kishte pranuar ofertën – edhe pse ditë më parë kishte thënë se skuadra është e lënduar.

Kapiteni i Chelsea ishte në top

formë kundër Sllovenisë, duke bërë disa intervenime dhe ndaluar disa aksione kritike të Sllovenisë.

Mesfushori Frank Lampard ka thënë se shumica e lojtarëve ishin syçelë nga kënaqësia që kishte ofruar Capello. "Nuk keni nevojë të pini 10 birra – mjafton një", citon fjalët e trajnerit Lampard.

Trajneri ishte kritikuar pasi që Anglia nuk kishte arritur më shumë se një barazim kundër Algjerisë, por morali u ngrit pasi që heroi i Spurs, Jermain Defoe u tregua i shkathët.

Për një moment u duk se fitorja është larg dhe skuadra nuk do të arrinte të tejkalojë as fazën e grupeve. Mirëpo, fitorja në momentet e fundit e SHBA-ve kundër Algjerisë bëri që "Yanks" të jenë të parët në grup, për shkak se shënuan më shumë gola.

Capello bëri tri ndryshime themelore nga skuadra bazë. Defoe erdhi në plan të parë para Emile Heskey, ndërkaq krijuesin e rasteve James Milner e vendosi në fushë para Aaron Lennon në anën e djathtë, përderisa Matthew Upson u vendos në vendin e Jamie Carrager. Kur u dha fshkëllima e fundit, trajneri buzagaz dhe i dehuri David Beckham ia "cakën" njëri-tjetrit dorën.

"Ne luajtëm së bashku, luftuam së bashku. Kjo është skuadra që unë njoh. Ne do të shkojmë përpara – tani e kemi mendjen e lirë dhe luajmë lojën tonë".

SHBA nuk ndalet

Ylli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Landon Donovan është zotuar se ekipi do të ofrojë edhe më tepër pas golit të fitores kundër Algjerisë, që ua siguroi pozitën e parë në Grupin C. Donovan realizoi në minutën e 92-të, duke shpëtuar ekipin e tij nga eliminimi në rast të përfundimit të ndeshjes me rezultat të barabartë. Pas takimit, Donovan ishte përlotur nga gëzimi, derisa ishte vërsuar nga bashkëlojtarët e tij. Ai tha: "Ka qenë rrugë e gjatë këtyre katër viteve të fundit dhe jam i mahnitur. Ndihem krenar për ekipin. Ne vazhduam lojën tonë dhe

besuam deri në fund". "Të afërmit e mi e dinë sa shumë kam punuar për të mbërritur deri këtu. Është e pabesueshme. E di se na përcjellin me vëmendje në shtëpi, por nuk do të ndalemi me kaq", shtoi ai. Sulmuesi i Los Angeles Galaxy përshkroi golin e fitores kundër Algjerisë. "Ata sulmonin në kërkim të golit, ndërsa mbrojtësit tanë luajtën shumë mirë. Kam marr topin, pasova për Jozyn dhe fillova të vrapoj. Topi më erdhi në një pozitë nga e cila nuk mund të gaboja", përfundoi ai. SHBA do të takohet me Ganën në fazën e dytë të shtunën.





Rooney do të jetë gati

Ylli i Anglisë, Wayne Rooney është optimist se do të jetë i gatshëm të paraqitet në ndeshjen kundër Gjermanisë të dielën, në fazën e dytë të Kampionatit botëror. Rooney ishte zëvendësuar pas 72

minutave në fitoren 1-0 ndaj Sllovakisë të mërkurën për shkak të një lëndimi në nyjën e këmbës. Pas takimit, selektori i Anglisë, Fabio Capello, mohoi rrezikun e mungesës së Rooneyt për

ndeshjen e ardhshme, edhe pse sulmuesi mungoi në stërvitje të enjten për shkak të kujdesit. Rooney dukej se çalonte pas rikthimit në Rustenburg të mërkurën, por ylli i

Manchester Unitedit ka insistuar se do të jetë i gatshëm për takimin kundër Gjermanisë në Bloemfontein. "Nyja ime do të jetë në rregull", tha Rooney për tabloidin anglez The Sun.

Goli më i rëndësishëm në karrierë



Selektori Diego Armando Maradona i kishte mbetur borxh Martin Palermos, pasi sulmuesi i Boca Juniors ia siguroi kualifikimin në Botërorin 2010 me golin vendimtar që e kishte shënuar kundër Perusë në kualifikimet për këtë eveniment. Dhe, legjenda e futbollit argjentinas e fshiu këtë borxh: jo që e ftoi në Afrikën e Jugut, por, përkundër moshës së shtyrë (36 vjeç), ia dha mundësinë veteranit Palermo që të luante në minutat e fundit në ndeshje me Greqinë. Vetë Palermo ka rrëfyer

për prapaskenën e ndodhur disa minuta para se të futej në lojë kundër grekëve. "Janë dhjetë minutat jetësore, më tha Diego. Këtë e ndjeva në atë moment. Hyra në fushë dhe kisha në mendje këto fraza të Maradonës. Dhe, e realizova golin më të rëndësishëm të karrierës sime. Sepse këtë e bëra në fanellën e Seleccion të Argjentinës", ka thënë Palermo i cili u inkuadrua në lojë në minutën e 81-të në vend të Militos, kurse golin e karrierës e realizoi në minutën e 89-të.

FOTOEXPRESS



Përfaqësuesja e Francës ka ateruar të enjten në aeroportin e vogël të Bourget, afër Parisit. Policia ka ruajtur pistën që lojtarët të largohen nga aty pa u shqetësuar nga gazetarët dhe adhuruesit. Ata nuk arritën ta kalojnë Grupin A, duke u renditur në vendin e fundit. Thierry Henry ka fluturuar me një aeroplan të veçantë për t'u takuar me presidentin francez, Nicolas Sarkozy. Ndërsa gazeta sportive franceze L'Equipe e ka përshkruar gjendjen e ekipit si "skandal shtetëror". | FOTO: GETTY IMAGES



FAJI I DIKTATORIT

Diktatori i Koresë së Veriut, Kim Jong-II, fajësohet për humbjen turpëruese nga Portugalia me rezultat 7-0. Pas përfundimit të 45 minutave të parë (1-0), ai dyshohet se ka këshilluar trajnerin Kim Jong-hun të aplikojë lojë ofensive gjatë pjesës së tyre. Rezultati ishte katastrofal.

Pas turpërimit të Koresë së Veriut nga Portugalia të hënën me rezultat 7-0, në ndeshjen e tyre të dytë në Grupin G të Kampionatit botëror, faji i është hedhur personalisht diktatorit korean, King Jong-II.

Selektori i ekipit, Kim Jong-hun, ka njoftuar se diktatori i "jep këshilla të vazhdueshme taktike gjatë ndeshjeve nëpërmjet një celulari të padukshëm". Trajneri shtoi se mjeti komunikues është zbulim personal nga Kim Jong-II.

"Duke pasur parasysh si funksionon regjimi i Koresë së Veriut, një trajner futbollit nuk mund të përmend emrin e Kim Jong-II ashtu siç dëshiron ai", tha një zyrtar i Koresë së Veriut.

"Celulari i padukshëm mund të tingëllojë si mjet i trilluar, por me gjasë është i vërtetë sepse urdhrat nga Kim Jong-II i drejtohen trajnerit", shtoi ai.

Ndërsa, një burim i afërm me trajnerin Kim Jong-hun, që e njeh mirë taktikën e tij, ka thënë se pjesa e dytë e ndeshjes kundër Portugalisë nuk ishte luajtur në strategjinë e lojës së zakonshme të trajnerit dhe duket se ekzistonte presioni nga jashtë.

"Kim Jong-hun është i kompozuar dhe i qetë, aplikon taktikë defansive pasi gjatë karrierës si futbollist ka qenë mbrojtës, por në pjesën e dytë kundër Portugalisë, Koreja e Veriut aplikoi taktikë të orientuar në sulm duke krijuar hapësira të mëdha në mbrojtje", tha burimi. P

Pjesa e parë e takimit përfundoi me rezultat 1-0, por në të dytën ekipi i Carlos Queirozit shënoi edhe gjashtë gola të tjerë. Duket se Koreja e Veriut kishte shpresë të mëdha për këtë takim, i cili ishte transmetuar drejtpërdrejt për herë të parë në historinë e saj.

Kim Yong-hyun, profesor në

Universitetin Dongguk, tha: "Udhëheqësia e Koresë së Veriut duket se ka kërkuar një fitore në Kampionatin botëror në formë ngushëllimi për problemet e saj ekonomike dhe diplomatike".

Ndërsa një zyrtar i qeverisë ka shtuar: "Paraqitja e guximshme dhe e disiplinuar kundër Brazilit më 16 qershor shtoi shpresat në ekipin e Koresë së Veriut, por instaloi besim të tepruar te njerëzit".

Atmosfera në Veri thuhet se është e zymtë pas turpërimit nga Portugalia. Kim Sung-min, i cili udhëheq radiostacionin Free North Korea Radio, ka thënë: "Kemi kontaktuar banorët dhe ata ndihen të zhgënjyer dhe të brengosur. Kishte të atillë që ishin aq të brengosur sa që thanë se kurrë nuk do t'ua falin futbollistëve". Koreja e Veriut e zhvillon ndeshjen e tyre të fundit në Grupin G kundër Bregut të Fildishtë, të premtën.

Gercaliu nënshkruan me Ingolstadt

Futbollisti shqiptar Ronald Gercaliu do ta vazhdojë karrierën e tij në futbollin gjerman. 24 vjeçari ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me klubin gjerman FC Ingolstadt 04, që sezonin e ardhshëm do të garojë në Ligën e Dytë gjermane. Trajneri i këtij klubi,

Michael Wiesinger, ndihet i lumtur që do ta ketë në ekip tashmë ish futbollistin e klubit austriak FC Magna. "Ronaldi do të jetë një avantazh i madh për ne dhe një element i rëndësishëm për skuadrën tonë, në divizionin e dytë gjerman", ka thënë Wiesinger.

Tiranasi deri tash kishte 14 paraqitje për përfaqësuesen e Austrisë. Më parë, ai ka luajtur në klubet austriake: Sturm Graz, Red Bull Salzburg, Austria Vienna e FC Magna. Ndeshjen e fundit me përfaqësuesen austriake mbrojtësi shqiptar e ka zhvilluar më 15 tetor

të vitit 2008, në kualifikimet për Botërorin 2010, kundër Serbisë në Vjenë. Gercaliu është përforcimi i gjashtë i Ingolstadt gjatë afatit kalimtar të verës, pas Sascha Kirschstein, Sebastian Zielinsky, Manuel Hartmann, Sebastian Hofmann e Amaechi Igwe.



ANGLEZËT BUDALLENJ

Franz Beckenbauer ka kritikuar sërish Anglinë. Legjenda e futbollit gjerman mendon se Anglia ka bërë gabim të madh, pasi ka dështuar t'i shmanget përbaljes me Gjermaninë në fazën e dytë të Kampionatit botëror.

Dy skuadrat, Gjermania dhe Anglia, që njihen për rivalitetin e ashpër, do të takohen këtë të diele në fazën e dytë të Kampionatit botëror, pasi që anglezët dështuan të jenë të parët në Grupin C.

"Torollakët, anglezët, rrëshqitën pak për të përfunduar të dytët në grupin e tyre. Anglezët dukeshin paksa të lodhur, ata ishin të rrsakapitur. Ne i respektojmë ata, por nuk u frikësohemi", tha i madhi Beckenbauer.

Anglia ka fituar kundër Sllovenisë duke siguruar një vend në mesin e 16 skuadrave më të mira, mirëpo ata nuk do të ndeshen kundër Ganës pasi që SHBA mundi Algjerinë duke kryesuar në grupin C me golevrazh më të mirë se Anglia.

Beckenbauer kishte kritikuar më parë stilin e lojës së Anglisë, duke thënë se ata kanë ngecur prapa duke iu kthyer ditëve të vjetra kur zbrapsen dhe nguten. Mirëpo, ka pranuar se kanë qenë më të mirë në ndeshjen e fundit të grupit.

"Dy paraqitjet e mëparshme të Anglisë në Botëror ishin të mjepra, mirëpo ata janë përmirësuar me Slloveninë", tha Beckenbauer, i cili ka fituar Botërorin edhe si lojtar dhe edhe si trajner, për gazetën gjermane Bild.

"Ajo çfarë i bën ata të rrezikshëm është se kanë lojtarë të mirë si Frank Lampard, Steven Gerrard dhe John Terry, të cilët e shohin këtë Botëror si mundësinë e fundit për të fituar trofe në një eveniment të këtillë. Para se gjithash Anglia është duke pritur për trofe që nga viti 1966. Ata kanë dështuar të kualifikohen në Euro 2008", tha ai.

Sipas tij, Anglia nuk ishte "kërkah", mirëpo paraqitja Fabio Capellos duket se ka vënë disiplinë te skuadra dhe

ai ka bërë një strukturë të re të saj.

Beckenbauer thotë se një lojë sikurse kjo (Angli - Gjermani) do të ishte mirë të luhej në gjysmëfinale dhe jo në të tetën e finales.

Megjithatë, ai beson që lojtarët gjermanë janë më të freskët se ata anglezë, pasi që anglezët kanë një sezon më të vështirë të lojërave në Premier League.

"Lojtarët e Premier Ligës luajnë më shumë lojë sesa kolegët e tyre në Bundesliga, përfshirë edhe dy gara që kanë për kupë", shtoi Beckenbauer.

"Kështu, kur është puna të Botërori apo Kampionati evropian, ata janë të lodhur. Lojtarët tonë, në anën tjetër, kanë gjendje më të mirë fizike", tha në Beckenbauer.



E fik Franca

Eliminimi i Francës qysh në fazën e grupeve nga kampionati botëror Afrika e Jugut 2010, nuk i ka bërë të qajnë vetëm francezët. Eliminimi e parakohshëm të "Këndezëve" e ka qarë edhe një bastexhi anglez, i cili në bastoren William Hill kishte besuar shumë të Bleus. Siç njofton e përditshmja Agicos, ky anglez kishte shkuar aq larg, sa që kishte investuar 55 mijë funte (67 mijë euro), me bindjen se djelmohat e Raymond Domenech do ta kalonin fazën e grupeve. Anglezi llogariste se mund ta fitonte dyfishin e parave, 110 mijë funte (134 mijë euro), por në fund mbeti duarthatë. Franca zhgënjeu në

Botërorin 2010 duke përfunduar në pozitën e katërt, të fundit në Grupin A. Ky ekip ka grumbulluar vetëm një pikë nga tri ndeshje, prej tyre 2 barazime e një humbje, që

nuk i mjaftuan për të kaluar në fazën e dytë. Kushedi, përpos këtij anglezi, sa bastexhinj të tjerë kanë mbetur me xhepin thatë pas eliminimit të francezëve.



Ozil, shpëtimtari i Gjermanisë

Një ditë pas fitores ndaj Ganës, shtypi gjerman e ka vlerësuar si "Shpëtimtarin" e Gjermanisë lojtarin Mesut Ozil. "Është fakt, Ozil e shpëtoi Gjermaninë. Ai shënoi një gol ëndërrimtar", ishte titulli i tabloidit Bild, sipas të cilit Botërori i vërtetë fillon qysh tash, pasi Gjermania do të luajë në të tetën e finales kundër Anglisë. Tabloidi tjetër gjerman BZ e titullon shkrimin "Yes", ndërsa shton: Mesut, ti je shpëtimtari ynë. Kurse e përditshmja Berliner Zeitung shkruan: "Përpara, gjithmonë përpara". Përkundër fitores ndaj ganezëve, selektori Joachim Loew kërkon më shumë nga lojtarët e tij. "Mund të jemi të kënaqur me rezultatin, por jo edhe me mënyrën se si kemi luaj-



tur. Duhet të luajmë më mirë, Anglia është skuadër e një kalibri tjetër", tha ai. Gjermanët e konsiderojnë ndeshjen me Anglinë histo-

rike, ngase gjithmonë kur kanë luajtur këto dy skuadra, është parë një luftë e vërtetë dhe ato përbalje nuk harrohen asnjëherë.

**DËRGO ME SMS NË 4949 KODIN QË GJENDET BRENDA
PRODUKTTIT DHE BËHU PJESE E LOJËS SË MADHE SHPËRBLYESE**



World Cup



South Africa 2010

Patos

Chipso

IPKO

Hapat për pjesëmarrje në lojën shpërblyese të organizuar nga IPKO dhe Patos:

Dërgo **SMS** në **4949** me kodin që gjendet brenda produktit (Patos, Patos rolls apo Chipso) dhe fito:

- Shpërblimin kryesor **veturë Ford Fiesta**, dhe
- **Çdo ditë shpërblimet:**
 - Kapela
 - Topa të futbollit
 - Topa origjinal të kampionatit botërorë 2010
 - Televizion Plazma
 - Pako Premium të televizionit digjital IPKO
 - Mbushje të telefonisë mobile IPKO në vlerë prej 1 EURO
 - Telefon mobil Nokia 2626

Çmimi për SMS është 20 cent.

Të gjithë SMS-ët validë të dërguar do të inkuadrohen në tërheqjen e shpërblimit kryesor për veturën Ford Fiesta.

Për më shumë informata vizitoni www.ipko.com

Loja shërblyese fillon me 7.6.2010 dhe zgjat deri më 12.7.2010, në mesditë.